

Harxhimet e zyrtarëve

Rreth 33 milion euro kanë shkuar në vetura

Fq.6



INTEGRIMI I TË VERBËRVE

Ndihma e institucioneve është e pamjaftueshme

Fq.9



Veseli fiton medaljen e bronzë në Argjentinë

Karate

Fq.27



Koha

www.koha.mk



Katharina, liderja e re që mposhti "gardën e vjetër" në Gjermani

Fq.17

EDITORIAL

Kur intelektualin e mund aparatçiku!



Në Maqedoni kurrfarë vlere nuk ke si intelektual shqiptar nëse nuk je anëtar i ndonjë partie politike. Me këtë konstatim u desht të ballafaqohet edhe një kuadër femër nga Shkupi, që mbi tri dekada kishte vepruar në Prishtinë dhe në fund i bie që gjithë ajo përvojë në gazetari, në shoqëri civile dhe në jetën kulturore...

Fq.2

GLOBI

"Gishtat ia prenë", kërkohet konsulli saudit që ndoqi torturat ndaj gazetarit

Fq.17

RAJON

Miratohet projektligji për FSK-në

Fq.2



DITË VENDIMTARE PËR MAQEDONINË

NË MES TË ZGJEDHJEVE TË PARAKOHSHME DHE MARRËVESHJES POLITIKE



Pavarësisht se Rregullorja e Kuvendit mundëson diskutim deri në 10 ditë në fazën e parë të ndryshimeve kushtetuese, votimi nuk është i lidhur me afatet. Në rast se shumica nuk është e sigurt në numrat e nevojshëm, akti i votimit mund të shtyhet për disa ditë duke i dhënë kështu hapësirë shumicës për intensifikimin e negociatave me kolegët nga opozita

Fq.3

Besiana Mehmedi vjen me koncert për Nënë Terezën në Shkup

Mezzosopranoja e njohur dhe profesoresha Besiana Mehmedi sjell koncert për 15 vjetorin e lumturimit dhe 90 vjetorin e shtegëtimit të Nënë Terezës. Në koncert do të interpretohen vepra nga Massnet, Guno e Schubert ndërkaq vjen edhe vepra e plotë e Pergolesit "Stabat Mater" që ka një tematikë shumë shpirtëror e mistike që lidhet me figurën e Nene Terezës. Koncerti

për artdashësit e shumtë, posaqërisht ata që janë në Shkup ipet të dielën në sallën kamertale të Filharmonisë së Maqedonisë me fillim në orën 19:00. Bashkë me të është dhe profesoresha universitare Sllavica Galic-soprano e Operes dhe Baletit të Maqedonisë. E ftuar speciale është jezz këngëtarja e njohur Stacey King ndërkaq moderimi bëhet nga Avni Qahili.



EDITORIAL

KUR INTELEKTUALIN
E MUND APARATÇIKU!

Emin AZEMI

Në Maqedoni kurrfarë vlere nuk ke si intelektual shqiptar nëse nuk je anëtar i ndonjë partie politike. Me këtë konstatim u desht të balafaqohet edhe një kuadër femër nga Shkupi, që mbi tri dekada kishte vepruar në Prishtinë dhe në fund i bie që gjithë ajo përvojë në gazetari, në shoqëri civile dhe në jetën kulturore, përgjithësisht, të mos mjaftojë për burokratët partiakë, të cilët pa e dridhur as qerpikun e syrit, prishin tre konkurse dhe përfundimisht vendosin kriteret ekskluzivisht partiake për ata që do të drejtonin ndonjë institucion publik, me karakter kulturor, siç mund të jetë, bie fjala, Muzeu i shtëpisë së "Nënës Terezë" në Shkup.

Qenkeshim gabuar kur kemi menduar se një parti opozitare, që është kritikuese e rreptë e pushtetit, punën e parë që do të bëjë kur të vijë vet në pushtet do të jetë flakja e deformimeve dhe idiotizmave që i kishte praktikuar pushtetit pararendës. Parasegithash, kishim menduar që ajo parti opozitare do të lirohej nga virusi i dëmshëm i partizimit, me çdo kusht, të jetës shoqërore, aq më tepër kur pikërisht ajo parti, që vetes i thotë edhe Lëvizje, në ditët e vështira opozitare kishte premtuar se do të jetë shumë e hapur ndaj intelektualëve e njerëzve të ideve, duke i angazhuar ata, pa qenë nevoja domosdoshmërisht të jenë demokrit militant të kësaj partie. Dhe shumica e njerëzve iu besuan këtyre premtimeve, mirëpo po del që krejt ky muhabet paska qenë një punë e kotë, një punë që dinë ta bëjnë vetëm ata që fjalët i kanë të mëdha, e veprat shumë të vockëla. Ata që e prishin konkursin disa herë, duke refuzuar një kuadër të përgatitur dhe me shumë "background" profesional e intelektual, vetëm e vetëm që të gjejnë ndonjë fëmijë të posadatur nga shkolla, për ta bërë drejtor, paçka se atij gjithë mandati do ti shkojë duke mësuar për punët që duhet ti kryej, shumicën e të cilave ia cakton partia, sipas platformës dhe diskutit të saj politik.

Pra, kemi ardhur deri në këtë derexhe që të refuzohen kuadro të dëshmuar, kuadro që gjithë karrierën profesionale ia kanë kështuar ideve e projekteve shoqërore e kulturore dhe në vend të tyre të pranohen kuadro që përkatësinë partiake e kanë vlerën e vetme për të qenë në krye të një institucioni. Sa e mjerë është ajo shoqëri që udhëhiqet me ide të tredhura politike, që gjithçka që projektton e mat me kutin e amatorizmave partiake, tipike për njerëzit që prodhojnë shterpësi mendimi e veprimi edhe për eksport.

Kishim menduar gabimisht se me përfundimin e epokës së monizimit do të marrin fund edhe praktikata e palavdishme kur edhe gomari mund të ishte dikushi nëse e ka librezën partiake. Nuk e kemi ditur se gomarllëqe të tilla, me variante edhe më bizare, do të na reprizohen edhe tash në kohën e demokracisë, kur djemtë e rijë, të posadatur nga pelenat e inferioritetit social, bëhen faktorë që të vendosin për fatet e intelektualëve të këtij vendi. Nëse shkohet sipas kësaj logjike, në shoqërinë shqiptare duhet të shuhet të gjithë zërat intelektualë dhe të gjithë të zënë rendin për t'u bërë anëtarë partie nëpër degë e nëndegë dhe si majmunë të përfundojnë në kafazin e liderit aparatçik, i cili as vet nuk e di se si i ka ra hise të udhëheq një organizatë partiake. Por, te ne gjithçka është e mundur, sepse a është vendosur ndonjë sistem vlerash që po deshka ta respektojë lideri?! Madje ky i fundit, duke mendu se është bërë edhe i mençur, harron të ndëzë llampën që ia ofron ndonjë intelektual për të kaluar më lehtë tunelin e errët të të panjohurave që i imponon koha. Ecjet e tilla nëpër terr i kishim lufuar me dekada, por qenka shumë e dhimbshme kur kjo ecje preferohet ende me vetëdëshirë nga aparatçikët tanë partiakë që refuzojnë intelektualët dhe preferojnë çuna të pasprovuar në punë e tyre që duhet ti kryejnë me ndonjë patericë shkoze që ia ofron partia, e proklamuar dikur si ridentifikuese e statusit të shqiptarëve në Maqedoni!

Fati i jetës në Maqedoni

"Fatin e jetës e cakton perëndia, vetëm në këtë vend në faktin e jetës ndërhyjnë edhe shumë faktorë tjerë që veten e quajnë njeri. Një like i vetëm tek ne ta ndryshon jetën, vetëm një fotografi në kohën dhe vendin e paqëlluar të gropos investimin e jetës. Vetëm një fjalë e mirë nga një njeri i vetëm me ndikim në shoqëri të ngrit vlerat edhe sikur mos ti keshë ato.

Shpresa thonë vdes e fundit, tek ne e vetmja shpresë është të mos jemi kështu siç jemi. Një njeri i drejtë se çfar vlera ka në vete për fat të keq nuk nvalet prej tij që ti shpalo tek njerzimi por ajo nvalet nga shërbimet dhe nga individë që bien pre e shpifjeve ndaj tij. Thonë koha shëron plagët, dhe drejtësia vjen në fund, mirpo një e vërtetë që nuk thuhet në kohën e duhur më nuk është e vërtetë. Përderisa ne mundohemi për të nxjer në pah të vërtetën koha kalon, dhe atë në dëmin tonë, rinia iku, gropat na u shtuan, arsimit u degrada, poashtu dhe kultura, shëndetësia, ekonomia dhe borxhi po na fundos dita ditës. Çka më tutje?

Tetova ime aq e bukur me qindra burime uji, me lumë, male bjeshkë e fusha nuk e meriton këtë gjendje të rëndë ekonomike, unë ekonomistë nuk jam e as akademik por në mungesë të opinionit dhe reagimit të akademikëve po mundohem uffff Le ti kthejmë shpresën këtij vendi", ka shkruar një status në Facebook, Altrim Mamuti Shumi.

Kalimi nga dora në dorë e LDK-së!

"LDK nga Prof. dr. Ibrahim Rugova kaloi në dorë të Prof. dr. Fatmir Sejdiut, prej tij tek Prof. Dr. Isa Mustafa dhe tash nga Profesor Mustafa pritet të kalojë tek Akademik Lutfi Haziri, i cili nuk e përdorë titullin për shkaqe modestie!!! Nuk e di a është kjo ide e Hashim Thaçit, apo e Kadri Veselit për ta rehatuar një herë e mirë LDK-në!", ka shkruar një status në Facebook, Liri Loshi.

Skandalet e pandëshkuara seksuale në Medrese!

"Skandalet seksuale në Medresenë e Bashkësisë Islame shpërthyen serish. Para tetë viteve, ishte kolegu Visar Duriqi që publikoi një seri hulumtimesh për ngacmimet seksuale në Medresenë "Alaudin", në Prishtinë. Sot, kolegët e T7, publikuan detaje ekskluzive për ngacmimet seksuale në BIK. Në këtë histori, konkludimi është i njëjtë: Naim Ternava, kryemyftiu, i ka heshtur këto skandale. Per tetë vjet nuk ka ndermarrë asnjë masë ndëshkuese ndaj protagonisteve. Ne, mediat, po e kryejmë punën tonë. Obligimin për ta raportuar të vërtetën. Besimtarët e devotshëm mysliman duhet të organizojnë proteste para Bashkësisë Islame të Kosovës. Protestë kundër Naim Ternaves. Për shkak të mos veprimtimit të tij. Për shkak të heshtjes se skandaleve seksuale brenda BIK-ut", ka shkruar një profil në Facebook, gazetari Parim Olluri.

MEDIACitate

Miratohet projektligji për FSK-në

Kuvendi të enjten ka miratuar shqyrtimin e parë të projektligjit për shërbim në forcën e sigurisë së Kosovës. Shqyrtimi i parë i këtij projektligji ka kaluar me 96 vota pro.

Kuvendi me shumicë votash ka miratuar leximin e parë të projektligjit për ministrinë e Mbrojtjes dhe projektligjin për krijimin e forcës së sigurisë së Kosovës.

Ministri i FSK-së, Rrustem Berisha theksoi se hartimi dhe procedimi i projektligjit për ministrinë e Mbrojtjes është bërë në kuadër të normave kushtetuese.

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka reaguar pas votimit të tri projektligjeve për FSK-në. Veseli e ka uruar Kosovën për ushtrinë me këto fjalë: "KOSOVË, E GËZOFSH USHTRINË", ka thënë Veseli në llogarinë e tij në Facebook.

Kujtojmë, se Kuvendi i Kosovës në seancën e sotme ka shqyrtuar tri projektligje për FSK-në.

Pas votimit të tri projektligjeve për Ushtrinë e Kosovës, ka reaguar presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi.

Ai duke shpërndarë një video në rrjetin e tij social në Facebook, ka thënë se Bijat dhe bijtë më të mirë të vendit, ushtarët e Republikës së Kosovës, transmeton lajmi.net.

"Gjithmonë duke nderuar atdheun dhe në shërbim të të gjithë qytetarëve. Bijat dhe bijtë më të mirë të vendit, ushtarët e Republikës së Kosovës", ka shkruar presidenti.

Kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj ka deklaruar se sot ishte një prej ditëve më përcaktuese për vendin në konsolidim të shtetit dhe në rrugën drejt NATO-s.

Ramush Haradinaj ka thënë se me votimin në lexim të parë të pakos së ligjeve për FSK-në, deputetët e Kuvendit vulosën të drejtën e shtetit tonë sovran për tranzicionin e FSK-së në mandat ushtarak dhe mbrojtës, ofruese e sigurisë për të gjithë qytetarët dhe komunitetet. Kryeministri Haradinaj njashtu ka thënë se nga tranzicioni i FSK-së përfitojnë qytetarët e komunitetet në Kosovë, por edhe rajoni ynë dhe partnerët strategjikë.

Postimi i plotë: "Me të drejtë një prej ditëve më përcaktuese për vendin në konsolidim të shtetit dhe në rrugën drejt NATO-s. Me votimin në lexim të parë të pakos së ligjeve për FSK-në, deputetët e Kuvendit vulosën të drejtën e shtetit tonë sovran për tranzicionin e FSK-së në mandat ushtarak dhe mbrojtës, ofruese e sigurisë për të gjithë qytetarët dhe komunitetet, forcë multi-etnike e profesionale, sipas standardeve të NATO-s. Falënderoj secilin deputet veç e veç dhe të gjitha partitë politike nga pushteti dhe opozita, që për temat nacionale po dëshmojnë konsensus dhe unitet politik. Nga tranzicioni i FSK-së përfitojnë qytetarët e komunitetet në Kosovë, por edhe rajoni ynë dhe partnerët strategjikë".

(Lajmi.net, 18 tetor)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

BRETOSAT NDIEJNË ARDHJEN E DRIDHJEVE TË FORTA

Shkencëtarët do të mund ta kenë një bashkëpunëtor të ri në parashikimin e dridhjeve të forta-bretkosën modeste.

Shkencëtarët britanikë kanë vërejtur shpërnguljen masive të bretkosave nga vendbanimi i tyre natyral në Itali, disa ditë para tërmetit të madh. Tre ditë para tërmetit numri i bretkosave ka rënë në zero. Udhëheqësja e hulumtimit ka thënë se të dhënat tregojnë se bretkosat mund t'i vërejnë ndryshimet



si lirimi i gazeve apo grimcat e ngjeshura para tërmetit

DITË VENDIMTARE PËR MAQEDONINË

NË MES TË ZGJEDHJEVE TË PARAKOHSHME DHE MARRËVESHJES POLITIKE

Pavarësisht se Rregullorja e Kuvendit mundëson diskutim deri në 10 ditë në fazën e parë të ndryshimeve kushtetuese, votimi nuk është i lidhur me afatet. Në rast se shumica nuk është e sigurt në numrat e nevojshëm, akti i votimit mund të shtyhet për disa ditë duke i dhënë kështu hapësirë shumicës për intensifikimin e negociatave me kolegët nga opozita



OBRM-PDUKM-së.

Arsovski foli edhe për politikën e LSDM-së, që sipas tij e kanë sjellë shtetin të jetë lider në botë sipas mosbesimit në gjyqësi, duke potencuar se nga 140 vende gjendet në vendin e 128-të në kategorinë për gjyqësi të pavarur sipas Forumit ekonomik botëror.

Njohësit e çështjeve politike thonë ndërkohë se ndryshimet kushtetuese duhet të bëhen sa më parë që të jetë e mundur, pasi çdo variant tjetër i kërkimit të zgjidhjes, qoftë edhe zgjedhjet e parakohshme, "paraqesin rrezik, për shkak të epilogut të paparashikuar që mund të kenë".

Së fundmi edhe ndërkombëtarë kanë nxitur liderët e Kuvendit të Maqedonisë që t'i tejkalojnë politikën partiakë dhe ta shfrytëzojnë mundësinë historike për një të ardhme më të mirë të vendit.

Në anën tjetër, derisa LSDM-ja beson se kolegët opozitarë do të

tejkalojnë interesat partiakë dhe do të votojnë "pro", VMRO-DPMNE-ja shpreh qëndrimin unik të grupit parlamentar, kundër marrëveshjes së Prespës dhe ndryshimit të Kushtetutës. Në rast se nuk arrihen 2/3, LSDM-ja propozon shpërbërjen e Kuvendit dhe shpalljen e zgjedhjeve të parakohshme.

Besoj sinqerisht dhe ashtu siç theksova, besoj se nesër do ta kemi shumicën e nevojshme prej 2/3 për votim. Sipas vlerësimeve tona dhe gjithë asaj që kemi dëgjuar deri më tani nga diskutimet dhe deklaratimet e kolegëve tanë nga opozita, nuk ka asnjë deputet në VMRO-DPMNE dhe në koalicionin e tyre të cilët janë kundër anëtarësimit në NATO dhe BE. E kemi ndjenjën se jemi afër momentit historik dhe momentit i cili do t'i jep kahje tjetër vendit dhe historisë së këtij shteti, duke besuar të gjithë nga ne këtu se ajo është Maqedonia Evropiane"- u shpreh Tomislav Tuntev, de-

putet i LSDM-së.

Zgjedhjet nuk janë zgjidhje thonë nga grupi parlamentar i BDI-së, nga ku shprehen të bindur se nevoja për ndryshimet kushtetuese do të kalojë.

Për BDI-ë nuk ka nëse në këtë proces. Për BDI-në ka vetëm një Maqedoni të integruar plotësisht dhe barabarësisht në NATO dhe në BE. Alternativë tjetër nuk ka, plan B nuk ka. Nuk heqim dorë nga përpjekjet tona shumë intensive, shumë konstruktive, shumë dashamirëse dhe shumë inkluzive për të arritur në Kuvendin e Maqedonisë që do të hapte rrugën e Maqedonisë drejtë integritetit Euroatlantik"- tha Artan Grubi, Deputet i BDI-së.

Shpalljen e zgjedhjeve e kushtëzoi edhe partia e Hristijan Mickoskit. VMRO-ja kërkon kryeprokuror të ri dhe 100 ditë qeveri teknike. Opozita nuk mohon shkuarjen në zgjedhje edhe pa Qeveri teknike 100 ditëshe, duke i

mundësuar kështu LSDM-së që të shpall zgjedhje pa nevojën e votave të BDI-së.

Fillimisht të kalojë votimi për ndryshimet kushtetuese në të cilat VMRO-DPMNE-ja do të votojë kundër. Pas kësaj menjëherë duhet të nisë procesi i Qeverisë teknike dhe realizimi i të gjitha kërkesave tona dhe më pas menjëherë shkojmë drejtë zgjedhjeve"- pohoi Dimçe Arsovski, zëdhënës i VMRO-DPMNE-së.

Në mesin e numrave që shumica beson se i ka për ndryshime kushtetuese, llogarit edhe votat e partive opozitare shqiptare. Lëvizja Besa, krahu i Kasamit dhe Aleanca për Shqiptarët kanë njoftuar se do ta mbështesin nevojën për ndryshime, por që në fazën e dytë do të ndërhyjnë me amendamente për çështjet si kombësia në dokumentet e identifikimit dhe zyrtarizmi i gjuhës shqipe. Pavarësisht se Rregullorja e Kuvendit mundëson diskutim deri në 10 ditë në fazën e parë të ndryshimeve kushtetuese, votimi nuk është i lidhur me afatet. Në rast se shumica nuk është e sigurt në numrat e nevojshëm, akti i votimit mund të shtyhet për disa ditë duke i dhënë kështu hapësirë shumicës për intensifikimin e negociatave me kolegët nga opozita. Në diskutimin aktual të drejtën e fjalës nuk e kanë realizuar 15 deputet. (R.H)

ZAEV: DEPUTETË, T'I THEM "PO" MUNDËSISË QË ËSHTË PARA NESH

"Deputetë, t'i themi 'po' mundësisë që është para neve", shkroi kryeministri i Republikës së Maqedonisë, Zoran Zaev, në profilin e tij në "Facebook". Ai shtoi se historia i njeh vendimet e drejta. Ai ju drejtua deputetëve edhe përmes profilin në "Twitter", ku tha se të gjithë deputetët kanë obligim historik



para qytetarëve. "Të gjithë deputetët kanë obligim historik para qytetarëve që ta sigurojnë rrugën e Maqedonisë drejt stabilitetit dhe prosperitetit ekonomik. Kjo është rruga drejt NATO-s dhe BE-së që çon përmes marrëveshjes mes Maqedonisë dhe Greqisë", shkroi Zaev.

BISEDË TELEFONIKE ZAEV-CIPRAS PAS DORËHEQJES SË KOCIAS

Pas dorëheqjes së Nikos Kacias nga posti i ministrit të Punëve të Jashtme të Greqisë, kryeministri i Maqedonisë dhe Greqisë, Zoran Zaev dhe Alexis Tsipras, kanë realizuar një bisedë telefonike.

Sipas zëdhënësit të qeverisë greke Dimitris Sanakopulos, të dy

homologët e përsëritën dhe ranë dakord për të vazhduar punën për implementimin e Marrëveshjes së Prespës.

"Kryeministri kontakton rregullisht me z. Zaevin. Është e qartë se kryeministri i vendit fqinj nuk do të komentojë mbi situatën e brendshme dhe skenën e brend-

shme në Greqi, përkundër kësaj, ata pajtuan dhe kanë përsëritur atë që të gjithë e dimë se të dy po punojnë për Ballkanin e shekullit të 21 dhe të dy po punojnë për implementimin dhe hyrjen në fuqi të Marrëveshjes së Prespës"-tha Senakopulos në një intervistë me televizionin shtetëror grek ERT.



Të miturit, kryesisht vajza dhe djem nën moshën 14 vjeçare janë viktimat potenciale të trafikimit, të detyruar të lypin nëpër rrugë, të ofrojnë shërbime seksuale apo të martohen me pahir. Nëse vetëm gjatë këtij viti janë identifikuar shtatë viktimat të tregtisë me njerëz, po ashtu janë identifikuar po ashtu edhe 76 viktimat potenciale dhe mbi 170 të tjerë të rrezikuar

Koha

Evis HALILI

Shkup, 18 tetor – Shfrytëzimi seksual dhe i krahut të punës janë format domimante të tregtimit të qenieve njerëzore në Maqedoni. Të miturit, kryesisht vajza dhe djem nën moshën 14 vjeçare janë viktimat potenciale të trafikimit, të detyruar të lypin nëpër rrugë, të ofrojnë shërbime seksuale apo të martohen me pahir. Nëse vetëm gjatë këtij viti janë identifikuar shtatë viktimat të tregtisë me njerëz, po ashtu janë identifikuar po ashtu edhe 76 viktimat potenciale dhe mbi 170 të tjerë të rrezikuar. Kështu kanë bërë me dije nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, gjatë hapjes së fushatës sensibilizuese “Është kurth” dhe në Ditën evropiane kundër tra-

DITA EVROPIANE KUNDËR TREGTISË ME NJERËZ

TRAFIKANTËT, FAVORE SEKSUALE NGA TË MITURIT



fikimit të qenieve njerëzore. Sipas të dhënave të organizatës IOM, të mbledhura gjatë viteve 2006-2016, target i trafikimit seksual janë kryesisht gra dhe vajza të moshës 11 vjeçare, ndërsa viktimat të shfrytëzimit të krahut të punës janë burra deri në moshën 30 vjeçare dhe djem të mitur.

“Viktimat janë trafikuar për një periudhë nga dy e deri në dy vjet e gjysmë. Tutorët e tyre kanë përdorur si mekanizma kontrolli forma të ndryshme, për shembull më të rriturve në moshë nuk i kanë paguar rrogën, orët jashtë orarit të punës, i kanë mbajtur të izoluar nga

shërbimet mjekësore dhe dokumentet personale të identifikimit, ndërsa për fëmijët kanë përdorur taktika të tjera premtive, mashtrime, por edhe dhunim fizik dhe psikik” ka deklaruar Sonja Bozhinovska Petrushevska, drejtuese e Zyrës së organizatës ndërkombëtare të migrimit IOM. Gjatë këtyre ditëve në Maqedoni do të zhvillohen një sërë aktivitetesh edukative-parandaluese, si tribuna, punëtori me fokus grupe. Përfaqësues të MInsitrisë së Punëve të brendshme bënë me dije se është krijuar një njësi nacionale task-forsis, ndërsa janë duke u përgatitur edhe ndry-

shime ligjore për sanksionimin e trafikantëve dhe mbrojtjen e viktimave.

“Maqedonia nuk mund të përjashtohet nga kjo dukuri, por lufta e vërtetë e një shteti duhet të jetë e vazhdueshme dhe multistitucionale, duhet të zgjasë gjatë të gjithë vitit dhe të sigurojë një model adekuat të reagimit”, ka thënë koordinatori nacional i luftës kundër trafikimit Magdalena Nestorovska.

Numri i viktimave të tregtisë me njerëz rritet çdo vit në nivel global. Nikolla Bertolini, drejtues i sektorit të bashkëpunimit në Delegacionin e BE vuri në dukje se një nëmur i madh burrash dhe grash bien në duar të trafikantëve në vendet e tyre, dhe pa dallim nëse edhe vend transit ose jo, asnjë nuk i ka shpëtu fenomenit të trafikimit. Sipas Bertolinit parandalimi i trafikimit përbën një nga sfidat më të mëdha me të cilat përballet bota, sidomos mbrojtja e viktimave që vijnë nga familje të varfra dhe të rrezikuara në shoqëri.

Fushata zhvillohet nga IOM, mbështetur edhe nga BE dhe MPB dhe MPPS.



Uashingtoni rekomandon tejkalimin e politikave partiake

Stetet e Bashkuara i nxisin liderët e Kuvendit të Maqedonisë që t'i tejkalojnë politikat partiake dhe ta shfrytëzojnë mundësinë historike për një të ardhme më të mirë të vendit.

Ky është qëndrimi i një funksionar i Departamentit Amerikan të Shtetit, i shprehur për Agjencinë greke të lajmeve ANA MPA.

“SHBA fuqishëm e mbështet implementimin e plotë të marrëveshjes, që do t'i mundësojë Maqedonisë që ta merr vendin e saj në NATO dhe BE si Republika e Maqedonisë së Veriut, duke kontribuar për stabilitetin rajonal, sigurinë dhe prosperitetin. Pasiqë në Kuvendin e Maqedonisë vazhdon diskutimi për ndryshimet kushtetuese, i nxitim liderët që të tejkalojnë politikat partiake dhe ta shfrytëzojnë këtë

mundësi historike që të sigurojnë të ardhme më të mirë për vendin e tyre, si anëtare e plotë në institucionet perëndimore”, deklaroi funksionari i departamentit amerikan. Ai i pyetur lidhur me dorheqjen e Nikos Kotziasit, ka deklaruar se i faleminde-rohen atij për përkushtimin e treguar për përfortimin e raporteve mes SHBA-së dhe Greqisë, si dhe për kontributin e dhënë në arritjen e Marrëveshjes historike të Prespës.

Rajoni i Pellagonisë do të ketë arsim më cilësor

Shkup, 18 tetor – Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Arbër Ademi ka pritur sot në një takim pune zyrtarë dhe përfaqësues politik të banorëve nga rajoni i Pellagonisë.

Në takimin me Xhemil Qamilin, kryetarin e Komunës së Dollnenit me Musa Ibrahimin, zëvendësdirjtorin e Agjencisë së Kadastrit dhe njëherit ish-deputet i kësaj zone dhe me Elgafar Jusufin, drejtorin e Agjencisë për nxitje të zhvillimit bujqësor në Manastir, është diskutuar rreth përpjekjeve që bën Ministria e Arsimit dhe Shkencës në drejtim të avancimit dhe rritjes të cilësisë së shkollimit për nxënësit e kësaj ane.

“Përmirësimi i cilësisë së shkollimit është njëri prej prioriteve kryesore të Ministrisë dhe Qeverisë dhe, në këtë plan një vëmendje të posaçme do të kenë pikërisht zonat e lëna pas dore, sa i takon afrimit të kushteve për realizimin e detyrimit ligjor për shkollim fillor dhe të mesëm”, tha mes tjerash ministri Ademi.



Në proces e sipër janë ndryshimet në Ligjin për arsim fillor, Ligjin për arsim të mesëm dhe Ligjin për standartin e nxënësve. Gjithë kjo ndërmarrje, bëhet me qëllim që të ofrojmë zgjidhje sa më të mira ligjore për zbatimin e reformave të paralajmëruara, ka sqaruar ministri i Ar-

simit. Me këtë rast, ai premtoi angazhimin e pakursyer të institucionit që drejton me qëllim të realizimit dhe avancimit të të drejtave për shkollim në gjuhën amtare për të gjithë nxënësit e shkollave të Dollnenit, Manastirit, e kështu me radhë. Përfaqësuesit e rajonit të Pellagonisë, u treguan të gatshëm të japin kontributin e tyre për zbatimin sa më të shpejtë dhe kualitativ të këtyre politikave, që në thelb kanë barazinë arsimore, si parakusht për zbatimin sa më të mirë të reformave që po ndërmerr Ministria e Arsimit dhe Shkencës, njofton Zyra për marrëdhënie me publikun pranë Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Xhaferi takon grupin e ekspertëve të BE-së për Ballkanin Perëndimor

Shkup, 18 tetor – Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, Talat Xhaferi, i shoqëruar nga nënkryetarët e Kuvendit dhe koordinatoret e grupeve parlamentare, ka pritur në një takim anëtarët e grupit të Punës, përgjegjës për marrëdhëniet e Bashkimit Evropian (BE) me vendet e Ballkanit Perëndimor, Shqipërinë, Bosnjë e Hercegovinën, Maqedoninë dhe Kosovën.

Siç sqaron shërbimi për

marrëdhënie me opinionin i Kuvendit të Maqedonisë, grupin e punës e përbëjnë ekspertë nga secili nga vendet anëtare të BE-së, që merren me çështje nga fusha e zhvillimit të përgjithshëm politik dhe ekonomik, procesin e stabilizimit dhe asociimit dhe Instrumentin financiar për ndihmë paraaderuese (IPA).

Gjatë takimit, thuhet më tej, anëtarët e grupit u interesuan për

ngjarjet aktuale në Kuvendin e Maqedonisë pas mbajtjes së referendumit, për çka Xhaferi i informoi për rrjedhën e debatit për Propozimin për qasje në ndryshimin e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, me udhëzime për ndryshimin dhe plotësimin e Kushtetutës me qëllim të zbatimit të Marrëveshjes me Greqinë.

Pjesëmarrësit këmbëzën mendime edhe për dinamikën e zba-



mit të proceseve reformuese në fushën e gjyqësisë, të shërbimeve të sigurisë dhe inteligjencës dhe luftën kundër korrupsionit. Nikoqirët kanë përshëndetur përkushtimin e institucioneve të BE-së për

perspektivën e zgjerimit me vendet e Ballkanit Perëndimor, ndërsa anëtarët e grupit shprehën gati-shmëri për përkrahje të plotë dhe ndihmë në rrugën e vendit kah anëtarësimi i plotfuqishëm.

Ky aplikacion për mediat dhe gazetarët është i një rëndësie të posaçme, sepse gazetarët do të kenë mundësi që të bëjnë krahasimin mes rendit të ditës që është publikuar dhe atij që është diskutuar

APLIKACION MOBIL NË TRANSPARENCËN GJYQËSORE

MË AFËR KËSHILLIT GJYQËSOR



AMNISTIA NUK JEPET NGA FOLTORJA E KUVENDIT

Ekspertja juridike, Margarica Caca Nikollovska, mes tjerash i komentoi zërat për amnistinë e të akuzuarve për ngjarjet e 27 prillit, me çka tha se duhet të parashtrahet dilema se vallë u propozua amnisti apo jo. Për shkak se ajo vlerëson se amnistia nuk ishte në atë formë që dikush dëshiron ta paraqes. "Aq më pak mundet të ofrohet një amnisti e tillë, nga një kryeministër, nga foltorja e Kuvendit. Çështjen për pajtim e kuptoj se të gjithë duhet të vetëdijsohemi se në çfarë pozite gjendet Maqedonia. Gjithsesi nëse nuk arrijmë pajtim që ti vlerësojmë cilat janë vlerat e një shteti, ne nuk do të kemi progres. Qytetarët janë tejet të hutuar. Për çdo ditë dëgjojnë teza të ndryshme. Vlerësoj se obligim i të gjitha partive politike është ti përcjellin drejtimit që do ta rrisin kualitetin e jetesës në vend. NATO dhe BE për të gjitha janë sfidë, të gjitha janë 'Për' anëtarësim në këto struktura. Mirëpo, nëse munde të hymë pa i përmbushur obligimet që i kemi marrë përsipër dhe i dijmë", tha Nikollovska.

Koha Omer XHAFFERI

Shkup, 18 tetor - Përmes aplikacioni mobil "Këshilli Gjyqësor nën Ilupë", Institutit për të Drejtat e Njeriut synon rritjen transparencës për punën e këtij organi të rëndësishëm gjyqësor. Kryetarja e këtij Instituti, ish gjykatësja Margarica Caca Nikollovska, tha se ky aplikacion është pjesë e projektit për monitorimin e punës së Këshillit Gjyqësor, me çka pas çdo mbledhje të Këshilli mediat dhe opinionit do të ketë mundësi të njoftohet për ngjarjet dhe vendimet e miratuara.

"Vlerësoj se ky aplikacion për mediat dhe gazetarët është i një rëndësie të posaçme. Njëkohësisht gazetarët do të kenë mundësi që të bëjnë krahasimin mes rendit të ditës që është publikuar dhe atij që është diskutuar. Çështje tjetër me rëndësi është se vallë për pikat e

rendit që publikohen me të vërtet hapet diskutim. Gjatë monitorimit të punës së Këshillit Gjyqësor ne kemi hasur shpesh se në rubrikën 'Ndryshe' vendosen pika tejet të rëndësishme. Kësajsoj transparenca vlerësojmë se nuk është përmbushur plotësisht. Drejtuesit e Këshillit Gjyqësor duhet ta kenë parasysh se transparenca nuk është vetëm informacioni, por ajo përmban më tepër elemente për kualitetin dhe punën e Këshillit Gjyqësor", tha Nikollovska.

Jasna Bačovska, profesoreshë

universitar, r cila ka punuar në metodologjinë e aplikacioni mobil, tha se funksioni social-politik i Këshillit Gjyqësor si një trup kritik i gjyqësori, përfundimisht është tepër labil.

"Projektet e IDNJ-së, kanë tepër rëndësi si në ngritjen e vetëdijes së opinionit profesional dhe atij të përgjithshëm. Pozita e Këshillit Gjyqësor në vendin tonë është e minimizuar. Vlerësoj se kemi bërë një metodologji të mirëfilltë për monitorimin e punës së Këshillit Gjyqësor, në bazë të cilit do të vërtetohen

(monitorohen) disa pika të dobëta, siç është formulimi i "juristit të shquar", kriteri ky i cili kërkohet për anëtarët e Këshillit. Kriteri në fjalë sipas meje është tepër labil dhe ende nuk dihet se cilët janë kriteret për të qenë anëtar i Këshillit Gjyqësor. Së fundmi ne ishim dëshmitar për debatin e detajuar që u hapë gjatë përzgjedhjes së një anëtari të Gjykatës së Lartë në SHBA. Në këtë rast ne kemi vendosur një pozicion të hapur të "juristit të shquar", respektivisht kemi vendosur një kor-

nizë klasifikuese, me kalimin e kohës e njëjtat të monitorohet dhe të ngritët vetëdija, duke filluar nga anëtarët e Këshillit Gjyqësor e kështu me radhë

Gjatë prezantimit të këtij aplikacioni, drejtuesit e IDNJ-së folën edhe për prapavija e vonimit apo prolongimit të zgjedhjes së kryetarit të Gjykatës së Apelit në Shkup. Sipas tyre arsye e zvarritjes së përzgjedhjes së kryetarit të kësaj nuk mund të vlerësohen për shkak se se mungon transparenca.

GOSTIVARI FILLON TRAJTIMIN E QENVE ENDACAK

Vite me radhë qytetarët e Gostivarit përballen me problemin e qenve endacak kur edhe ka patur raste të kafshimit të qytetarëve. Taravari nënvizon se nuk ka dëshmi se qent endacak sillen nga jashtë, por një rast e kanë denoncuar në polici



qentë endacak të cilët i kemi në rajonin e komunës së Gostivarit me këtë të paktën qytetarët do të jenë të sigurtë se qentë janë të parrezikshëm pasi që më parë ata janë trajtuar janë vaksinuar dhe shumica prej tyre edhe do të sterilizohen" tha Tarvari Taravari. Ai informoi se krahas kësaj do të fillojë edhe të funksionojë stacioni për qent endacak pasi që të licencohet.

"Ashtu edhe siç kemi paralajmëruar se do të fillojmë me trajtimin e problemit të qenve endacak, edhe pse përgatitëm një qendër për trajtimin e këtyre qenve në Gostivar në hapësirat e kazermës së vjetër në Gostivar megjithatë nga ana procedurale ende nuk jemi gati që atje të fillojmë me punë sepse duhet që të rregullohen edhe disa punë të vogla administrative që në mënyrë zyrtare ajo qendër për trajtimin e qenve endacak të fillojë me punë

të licencohet. Aktivitetet vendosëm që t'i fillojmë para se të fillojë me punë qendra për trajtimin e këtyre qenve. Për shkak se kishim procedurë tenderiale dhe tani nuk e di se sa firma janë paraqitur, veterinerët të cilët e fituan punën për të trajtuar qentë endacak këtu janë tetovar të cilët këtu zyrtarisht e kanë kryer operacionin e parë" theksoi ai.

Taravari nënvizon se nuk ka dëshmi se qent endacak sillen nga jashtë, por një rast e kanë denoncuar në polici. "Ekzistojnë spekulime të kësaj natyre se qentë sillen këtu nga qytete të tjera, në lidhje me këtë ne kemi edhe një dëshmi, një fotografi të një kamioni të cilin ne vet e kemi fotografuar duke sjellë qen këtu, dëshmitë i kemi dorëzuar në polici që ata të vërtetojnë mesiguri këtë rast. Megjithatë ende nuk është vërtetuar se a është me siguri kjo gjë, nuk dua të spekuloj se nga cili

qytet por megjithatë biseda të tilla vërtetë ka që qentë barten nga një qytet në tjetrin. Ne zyrtarisht nuk e dimë numrin e përgjithshëm të qenve endacak në Gostivar sipas asaj që thuhet nga disa njerëz të cilët edhe mund të kenë informacione rreth numrit të qenve në Gostivar dhe sipas tyre flitet se në Gostivar janë diku nga 300 deri në 500 qen endacak", nënvizon ai. Vite me radhë qytetarët e Gostivarit përballen me problemin e qenve endacak kur edhe ka patur raste të kafshimit të qytetarëve. Në ndërkohë, Komuna e Tetovës ka hartuar programë më serioze për trajtimin e qenve endacak, problem ky i kahmtoshëm dhe i pazgjidhur për qytetarët e Tetovës. Programi parashihet trajtim të qenve endacak ndërsa pritet që në seancën e radhës të jetë në rend dite edhe në këshillin e komunës së Tetovës për miratim. Programi është përgatitur në Sektorin për Tokë Ndërtimore dhe parashihet për zgjidhjen e problemit lidhur me praninë në rritje të

qenve endacake, përkatësisht për kontrollin e numrit të tyre, nga ana e Organizatës botërore për mbrojtjen e tyre, si mënyrë e vetme e mundshme është rekomanduar trajtimi human. Por nuk ka informacione se kur do të fillojë të realizohet në praktikë.

Shkup, shtatë aksidente për 24 orë

Shkup, 18 tetor - Dy persona kanë pësuar lëndime më të lehta trupore në gjithsej shtatë fatkeqësi rrugore që ndodhën në rajonin e Qytetit të Shkupit. Në pesë fatkeqësi është regjistruar vetëm dëm material. Sipas raportit policor të SPB Shkup, 32 vozitës kanë lëvizur me shpejtësi më të madhe nga e lejuara, 10 vozitës janë përjashtuar nga komunikacioni, katër prej të cilëve për shkak të drejtimit të automjetit nën ndikimin e alkoolit, gjashtë pa patentë shofer. Nga komunikacioni policia ka përjashtuar tre automjete të cilat kanë qenë në gjendje jo të rregullt teknike dhe shtatë automjete për shkak se kanë qenë të paregjistruara. Në mënyrë të parregullt kanë qenë të parkuara 106 automjete, ndërkaq automjeti i posaçëm ka mënjeluar 72 automjete. Policia ka sanksionuar edhe 20 këmbësorë të cilët kanë kaluar rrugën jashtë vendkalimit për këmbësorë, gjashtë këmbësorë të cilët kanë kaluar në dritë të kuqe të semaforit, gjashtë vozitës të cilët kanë kaluar udhëkryqin në dritë të kuqe të semaforit, një vozitës i cili nuk ka treguar përparësi ndaj këmbësorëve në vendkalim të shënuar për këmbësorë dhe tre për mosshfrytëzim të helmetës mbrojtëse nga ana e motoçiklistëve.

Koha Urim HASIPI

Gostivar, 18 tetor - Komuna e Gostivarit filloi me trajtimin e qenve endacak në rrugët e qytetit. Me këtë rast, sot në Tetovë në ambulancën e veterinarisë është kryer vaksinimi dhe kastrimi i kafshëve të kapura në rrugët e qytetit.

Kryetari i komunës së Gostivarit, Arben Tarvari, tha se është duke u punuar që të gjithë qent sa më shpejt të trajtohen. "Sot të gjithë ishim dëshmitarë të trajtimit me operacione dhe vaksinime të të gjithë qenve që ndodhen në Gostivar, atyre që vaksinohen u vendosen çipa në veshë ku shkruhet qyteti dhe numri i qenit që është trajtuar, unë mendoj që do të mundohemi në maksimum që sa më shpejt të trajtojmë të gjithë

ENTI SHTETËROR I PRONËSISË INDUSTRIALE SHËNON 25 VJETORIN

RRITJA E CILËSISË ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE

Koha Remzije BILALLI

Shkup, 18 tetor - Me rastin e 25 vjetorit të themelimit të Entit Shtetëror për Pronësi Industriale (ESHPI), sot në ambientet e Muzeut të Artit Modern u zhvillua konferenca me temë "Transferimi i Teknologjisë dhe të Drejtave të Pronësisë Intelektuale në Republikën e Maqedonisë"

Në këtë ceremoni u promovua "Monografia e 25 vjetorit të Entit Shtetëror të Pronësisë Intelektuale", ndërsa në takimin punues morën pjesë ekspert dhe përfaqësuesve të Entit Evropian të Patentave, Organizatës Botërore e Pronësisë Industriale, Qendrës së Përbashkët Kërkimore të Komisionit Evropian dhe Fondit për Inovacionin dhe Zhvillimin Teknologjik.

I pranishëm ishte edhe Ministri i Ekonomisë, Kreshnik Bekteshi i cili në fjalimin e tij theksoi se në bazë të hulumtimeve, numri i investimeve të huaja direkte është në përpjesëtim proporcional me nivelin e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë intelektuale dhe është me rëndësi të madhe korniza e vërtetuar ligjore dhe politike për të promovuar zgjidhje të reja që i përgjigjen



U promovua "Monografia e 25 vjetorit të Entit Shtetëror të Pronësisë Intelektuale", ndërsa në takimin punues morën pjesë ekspert dhe përfaqësuesve të Entit Evropian të Patentave, Organizatës Botërore e Pronësisë Industriale, Qendrës së Përbashkët Kërkimore të Komisionit Evropian dhe Fondit për Inovacionin dhe Zhvillimin Teknologjik

kërkesave të tregut. Sipas tij, sa më shumë vëmendje që i kushton shteti mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale, aq më i madh do të jetë numri i investimeve të huaja

"Me kënaqësi të madhe do të theksoj se rregulloret e Republikës së Maqedonisë në këtë fushë janë të harmonizuara me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale. Kjo mundëson mbrojtje efikase të këtyre të drejtave dhe siguri më të madhe ligjore për kompanitë e huaja dhe në të njëjtën kohë përmirëson klimën e investimeve në vend," tha Bekteshi.

Mes të tjerash ai shtoi se vlera e lartë e përdorimit të produkteve dhe shërbimeve si dhe prodhimi i produkteve të reja me vlerë më të lartë të shtuar, paraqet çelësin e for-

cimit të tregut të kompanive, ndërsa për Maqedoninë sfidë e veçantë është përcaktimi ynë për t'iu bashkuar BE-së dhe NATOos.

Drejtori i ESHPI, Safet Emruli rikujtoi rrugën nëpër të cilën ka kaluar ky institut për t'u bërë një institucion modern i cili tani më 10 vite është anëtar i plotë i Organizatës Evropiane të Patentave.

"Qëllimi ynë është rritja e cilësisë së shërbimeve me standardet ndërkombëtare në aspektin e mbrojtjes së të drejtave të pronësisë industriale në Republikën e Maqedonisë. Këtë e kemi bërë nëpërmjet projekteve dhe strategji-

ve të ndryshme. Deri më tani janë paraqitur 32.000 marka tregtare, 10.000 patenta, më shumë se 1.000 aplikime për dizajn industrial, ndërsa janë regjistruar 26.000 marka tregtare, 8.800 patenta dhe dhjetëra emra gjeografikë, nga të cilat 5 kanë mbrojtje ndërkombëtare," tha Emruli.

Përfaqësuesja Silvia Trpkovska, nga Drejtoria e Përgjithshme e Organizatës Botërore për Pronësi Intelektuale theksoi se më shumë se 25 vite kanë komunikim konstruktiv me Entin, i cili nënshkroi marrëveshje të rëndësishme në fushën e pronësinë industriale, duke vënë bazat për pjesëmarrje aktive të vendit në sistemin ndërkombëtar të pronësisë industriale.

"Marrëveshjet janë një gjë ndërkaq krijimi i një mekanizmi funksional për një sistem të pronësisë intelektuale është diçka tjetër. Pikërisht në këtë pjesë, unë do të doja të shpreh një respekt të veçantë për progresin e madh që vendi juaj ka arritur në një periudhë relativisht të shkurtër në drejtim të krijimit të një arkitekture nacionale legjislative dhe të infrastrukturës në sistemin e pronësisë intelektuale", shtoi Trpkovska.

HARXHIMET E ZYRTARËVE

Pushteti qendror dhe ai lokal së bashku makina kanë harxhuar gjithsejtë 33 milion euro për të blerë makina. Vetura më e shtrenjtë e blerë për nevojat e Ministrisë së Punëve të Brendshme është vetura Mercedes e llojit C600 në vitin 2012 me çmim furnizues prej 572.780 euro. Veturë më të shtrenjtë nget edhe kryetari i komunës së Sveti Nikollës në vlerë prej prej 77.839 euro

Koha Zejnulla VESELI

Shkup, 18 tetor - Çfarë vetura vozisin ministrat e Qeverisë së Maqedonisë dhe kryetarët e komunave me parat e qytetarëve. Analiza e fundit e Qendrës për komunikim me qytetarët tregon se të gjitha 15 ministrat më shumë makina në disponim ka Ministria e Punëve të Brendshme me 1.559 vetura për të cilët kjo ministri ka harxhuar 22 milion euro. Në vendin e dytë radhitet Ministria e Mbrojtjes me 142 vetura dhe Ministria e Bujqësisë me 108 vetura. Çmimi mesatar për veturat e blera sipas kësaj analize është 16.690 euro ndërsa viti mester i këtyre veturave është 12,5 vite. Parkun më të ri të veturave e ka ministria e Pushtetit Lokal dhe Ambientit jetësor

Rreth 33 milion euro kanë shkuar në vetura



dhe at mesatarisht 8,5 vite ndërkohë që vetura më të vjetra që për momentin i ka në posedim janë makinat që voziten në Ministrinë e Drejtësisë. Gjithashtu sipas kësaj analize ministritë dhe pushteti lokal së bashku posedojnë gjithsejtë 2.645 makina prej të cilëve 2.008 janë blerë më çmim furnizues prej 33 milion euro, ndërsa për 637 makinat institucionet nuk kanë të dhëna se më çfarë çmimi furnizues janë blerë. "Të gjitha ministratë përfshirë dhe Qeverinë e Maqedonisë në disponim kanë 2.215 vetura që kanë vlerë totale prej 27,2 milion euro, derisa komunat për momentin posedojnë 430 vetura në vlerë prej 5,7 milion euro", thuhet në analizën e Qendrës për komunikim me qytetarët. Në përgjithësi thuhet më tej në këtë analizë edhe pushteti qendror dhe ai lokal më së shumti kanë blerë vetura të llojit Shkoda, Wolk-

swagen dhe Ford.

"Megjithatë veturat më të shtrenjta janë blerë nga Ministria e Punëve të Brendshme të llojit Mercedes dhe at për mercedesin e llojit C600 në vitin 2012 me çmim prej 572.780 euro dhe dy mercedes tjerw qw tani i ka në disponim Ministria e Punëve të Jashtme. Pastaj ministria e Punëve të Jashtme ka të blerë veturë me çmim prej 81.301, ministria e Financave në vlerë 76.768 euro.

Në anën tjetër me veturë më të shtrenjtë në vlerë prej 77.839 euro vozitet kryetari i komunës së Sveti Nikollës dhe kryetari i komunës së Kavadarit në vlerë prej 70.075 euro" thuhet në analizën, Ndërkohë sa i përket numrit të punësuarve dhe veturave në komuna i bie që më pak veturë për të punësuar ka komuna e Dibrës dhe at një veturë për 61 të punësuar megjithatë kryetari i kësaj komune vozitet me veturë të re në

vlerë prej 49.000 euro. Komuna e Haraçinës krahasuar me numrin e të punësuarve dhe makinat që kanë disponim një veturë e shfrytëzojnë dy të punësuar. Megjithatë sipas kësaj analize shumë shqetësues është fakti se nga 2.645 makina sa i kanë disponim ministratë dhe kryetarët e komunave për 637 makina apo për çdo të katërtën veturë institucionet nuk kanë të dhëna se me çfarë çmimi janë blerë.

Kështu Sekretarijati për punë të përgjithshme dhe të përbashkëta pranë Qeverisë nuk jep të dhëna se sa ka kushtuar individualisht nga 113 vetura sa i kanë në disponim Qeveria prej të cilave 40 janë të llojit Pasat. Sipas të dhënave të Sistemit Elektronik për Furnizime Publike çdo veturë e llojit Pasat ka çmimi furnizues 40.237 euro. Nëse bëjmë krahasimin se cila komuna ka shpenzuar më shumë para për blerje të veturave në vendin e parë radhitet komuna e Sveti Nikollës e cila në vitin 2010 ka blerë makinë mercedes të llojit CDIR 320 për të cilin ka paguar 77.839 euro. Në vendin e dytë është kryetari i komunës së Kavadarit i cili në vitin 2005 ka blerë veturë mercedes të llojit E200 komprësor me çmim 70.075 euro pastaj komuna e Strugës për kryetari i komunës në vitin 2011 me para të buxhetit të komunës ka blerë veturë të llojit Audi A6 kutaro në vlerë prej 68.247 euro.

Po ashtu kryetari i komunës së Gostivarit në vitin 2014 ka blerë Audi A6 në vlerë 65.595 euro. Edhe kryetari i komunës Demir Kapija në vitin 2014 ka blerë veturë të re te llojit Pasat 2.0 TDI në vlerë prej 62.656 euro.

Ndërkaq komuna e Tetovës dhe Sarajit nuk posedojnë më të dhëna të sakta se sa para kanë harxhuar për blerje të veturave dhe çfarë lloji veturash posedojnë. Në përgjithësi më shumë para për blerje të veturave ka harxhuar qyteti i Shkupit dhe at 472 mijë euro për blerjen e 36 veturave. Vijon komuna e Karposhit me blerjen 16 veturave në vlerë të përgjithshme prej 303 mijë euro dhe kryetari i komunës së Ohrit ka harxhuar 293 mijë euro për 13 vetura të blera ndërsa komuna e Strugës për blerjen e 7 veturave ka harxhuar 206 mijë euro. Çmimi mesatar për blerjen e veturave nga kryetarët e komunave kap shifrën prej 15.051 euro.

Gjithashtu sipas kësaj analize nga gjithsejtë 2.645 vetura që posedon pushteti qendror dhe lokal 561 vetura janë donacione. Sipas statistikave më shumë vetura për nevojat e pushtetit qendror janë blerë nga janë blerë të llojit Shkoda dhe at 447 vetura, të llojit Volkswagen 329 dhe Ford 162 vetura ndërkaq për nevojat e pushtetit lokal po ashtu dominojnë veturat e llojit Shkoda me 61 vetura, Fiat 38 vetura Volkswagen dhe Ford me 35 vetura.

LUFTA ME VARFËRINË

BETEJË E GJATË DHE E MUNDIMSHME

Ekonomistët thonë se zbutja e varfërisë dhe ulja e papunësisë në Maqedoni, nuk është një proces aspak i lehtë dhe për të nuk ekziston një shkop magjik. Ai kërkon një sërë masash si në aspektin social, ekonomik, arsimor etj



Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 18 shtator - Varfëria dhe papunësia në Maqedoni, vite me radhë renditen ndër problemet kryesore që shqetësojnë qytetarët. Një e pesta e popullatës në Maqedoni është e varfër, apo me fjalë të tjera mbi 450 mijë qytetarë në vend janë të varfër tregojnë analizat. Sipas anketave të Entit të Statistikës, të varfër janë edhe 9 për qind e të punësuarve, 7 për qind e pensionistëve dhe 41 për qind e të papunëve. Sipas statistikës, pragu i varfërisë janë të ardhurat prej 6.880 denarë për amvisëritë prej një personi, ndërsa për familjet me katër anëtarë janë 14.488 denarë. Gjithashtu statistika tregon se 37 për qind e popullatës nuk kanë shkuar në kontroll mjekësor apo mjekim për shkak të mungesës së parave, ndërsa afër 60 për qind janë përgjigjur se nuk kanë shkuar në dentist, për shkak se nuk kanë mundësi të lejojnë vetes diçka të tillë.

Ekonomistët thonë se zbutja e varfërisë dhe ulja e papunësisë në Maqedoni, nuk është një proces aspak i lehtë dhe për të nuk ekziston një shkop magjik. Ai kërkon një sërë masash si në aspektin social, ekonomik, arsimor etj Nevoj-

tet që edhe ndihmat dhe masat konkrete të përshtaten ndaj kategorive të ndryshme, për shkak se ato nuk mund të jenë të njëjta për të gjithë të rrezikuarit nga varfëria. Me fjalë të tjera vlerësohet se ato duhet të dizajnohen në bazë të nevojave të grupeve të ndryshme në aspektin gjinor, etnik, moshës e kështu me radhë, me qëllim që të jenë më efikase dhe të kemi rezultate më të mira në uljen e varfërisë në shtet. Andaj bartësit e politikave nevojitet të krijojnë kushte që do të krijojnë mundësinë e rritjes më të madhe ekonomike prej 5-6 për qind për disa vite me radhë, që do të krijojë mirëqenie që do të ndjejnë të gjithë qytetarët e Maqedonisë. Nevojitet të përgatiten edhe masa më efektive afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjate që do të ndihmojnë grupet më të rrezikuara sociale ku bëjnë pjesë familjet shumë-anëtarëshe ku shpesh kreu i familjes nuk posedon arsim fillor dhe kualifikim përkatës.

“Së pari na nevojitet rritje më e madhe ekonomike, rritje e produktivitetit dhe hapja e vendeve të reja të punës me qëllim që të zvogëlohet përqindja e personave që jetojnë në rrezik nga varfëria për shkak se pjesa më e madhe e tyre janë të papunë. Gjendja nuk mund të përmirësohet vetëm me pë-

mirësimin e sistemit për mbrojtje sociale, por edhe me hapjen e vendeve të reja të punës që të mundën të varfrit të realizojnë të ardhura”, thotë profesora Maja Gerovska.

Nga ana tjetër, sociologët thonë se shteti nevojitet një vëmendje të veçantë ti kushtojë edhe personave që jo për fajin e tyre nuk kanë mundësi të punojnë dhe të realizojnë të ardhura.

“Si shet nevojitet ti përmbahemi masave të njohura botërore për të luftuar varfërinë siç janë edhe përkrahja më e madhe për personat që nuk kanë mundësi të kënaqin nevojat themelore jetësore. Pra, nevojitet një përkujdesje më e madhe për personat në nevojë, atyre që vuajnë nga sëmundjet e rënda, me paga shumë të ulëta dhe raste të ngjashme, duke ju ofruar një ndihmë afatgjate për mbijetesë së paku në aspektin minimal”, thotë profesori universitar Ilija Acevski.

Ndryshe, të dhënat statistikore tregojnë se, 30 për qind e popullatës në Maqedoni në vitin 2016 kanë qenë seriozisht e privuar materialisht që nënkupton pamundësinë e realizimit të së paku katër nga nëntë nevojat themelore siç janë: pagesa e qirasë apo komuna-

pagesa e harxhimeve të paplanifikuara, lejimi i vetes ngrënie me mish, peshk apo mish pule në çdo të dytën ditë, verimi një javor, automobili personal, disponimi me makinë për larje, televizor me ngjyrë apo telefon. Studiuesit thonë se varfëria është një koncept tepër kompleks dhe i vështirë për t'u matur. Andaj në 30 vitet e fundit studiohet një koncept i ri që përpillet të analizojë dhe të plotësojë konceptin e varfërisë, e cila shpesh matet kryesisht në tregues ekonomikë. Bëhet fjalë për përjashtimin social që nuk nënkupton vetëm nevojat e natyrës ekonomike, por edhe sociale, kulturore e politike. Përjashtimi social si burim kryesor ka më shumë probleme si papunësia, mungesa e kualifikimeve profesionale, të ardhurat e ulëta, mjediset e papërshtatshme për të jetuar, problemet shëndetësore, etj.

KINË, QINDRA MILION NJERËZ DALIN NGA VARFËRIA

Shkup, 18 tetor - Karatesiti shqiptar Faik Veseli ka fituar medaljen e bronzit në Lojërat Olimpikë për të rinj që po mbahen në Buenos Aires. Karateisti shqiptar në kategorinë deri më 61 kg në gjysmëfinale u përball karateistin japonez Masaki Jamaoka në të cilin takim humbi pas vërejtjes së katër nga referi kryesor. 17-vjeçari nga Shkupi, anëtar i KK "Olimpik" ka deklaruar se e ka pritur këtë medalje pasi ka qenë i përgatitur. "Ndjenja është e papërshkrueshme, nuk mund të gjej fjalë për këtë sukses. Medaljen e kam pritë, pasi kam qenë i përgatitur. Falënderoj trajnerët Aleksandar Kuzmanovski dhe Kristijan Mlladenovski. I falënderoj të gjithë për përkrahjen", deklaroi Veseli. Me herët në fazën e grupeve, Veseli fitoi dy meçe ndaj karateistit nga Jordania Abdal Hamad me rezultat 1:0 dhe ndaj argjentinës Rodrigo Tello me rezultat 6:0, ndërsa u mposhtë nga garuesi arab, Al Asiri me rezultat 4:0. Maqedonia në Lojërat Olimpikë në Argjentinë ka gjashtë përfaqësues, ndërsa kjo është medalje e parë e fituar. (F.N)



Krasniqi, optimist për duelin e 17 nëntorit

Haxhi Krasniqi është optimist se do ta fitojë duelin e 17 nëntorit në Dessau ndaj Stefan Hartelit për ta mbrojtur titullin e kampionit evropian.

"Kundërshtari mund të ëndërrojë. Unë do ta demonstroj forcën time dhe do të mbe-

tem 100 për qind fitues", ka thënë boksieri junikas në konferencë për shtyp. Kurse kundërshtari i tij ka thënë se do ta mposhtë Krasniqin dhe do ta çojë në pension pasi mendon se të gjithë boksierët mund të mposhten.



"EURO 2020"

Maqedonia dhe Kosova në evropian?

Shkup, 18 tetor - Përderisa një pjesë e madhe e të ashtuquajtura kombëtare të mëdha janë kundër garave në Ligën e Kombeve, përfaqësueset e vogla si ajo e Maqedonisë dhe Kosovës, shumë mirë janë duke shfrytëzuar këto gara të UEFA-së. Maqedonia dhe Kosova për momentin janë në një pozitë shumë të mirë që me lehtësi të sigurojnë kualifikimin historik në një evropian. Të dyja këto kombëtare janë të vendosura në Ligën "D", ku kushtimisht thënë bëjnë pjesë kombëtares më të dobëta. Maqedonia bën pjesë në grupin e katërt, në të cilin bëjnë pjesë - Armenia, Gjibraltari e Lihtenshtajni. Përfaqësuesja e vendit me një barazim eventual në ndeshjen me Ar-



meninë, matematikisht do kishte siguruar pozitën e parë në grup, por me humbjen 4:0 tani iu ka dhënë gjasa kombëtareve të tjera të shpresojnë për një rezultat të mirë në këto gara. Kosova bën pjesë në grupin e tretë në të cilin janë edhe Azerbajxhani, Malta dhe Ishujt Fare. Azerbajxhani ishte favorit për të fituar këtë grup, por këta në përball-

ljen me Maltën, fituan vetëm 1 pikë. Ndryshe nga këta Kosova, është befasia më e madhe e këtij grupi. Këta në përballjen me Ishujt fare humbën dy pikë dhe këtë mundësinë për të qenë të sigurt se do jenë të parë në grup. Krahas pikëve të humbura Kosova, me 8 pikë e kryeson renditjen e grupit të saj dhe ka 2 pikë më shumë se Azerbajxhani me

të cilët në nëntor do përballen në Prishtinë. Kjo do jetë ndeshja vendimtare e këtij grupi. Po që se Kosova dhe Maqedonia këtë fazë të Ligës së Kombeve e mbyllin në pozitën e parë në grupet e tyre, këta do sigurojnë ngjitje një rang më lart për edicionin e ardhshëm të Ligës së Kombeve. Këta po ashtu do sigurojnë edhe kualifikime plotësuese për "Euro 2020". Maqedonia dhe Kosova në eliminatorët plotësuese mund të përballen mes vete në dy ndeshje, ose së paku do të duhet të luajnë balotazh me Bjellorusinë apo Gjeorgjinë. Përmes këtyre ndeshjeve Maqedonia dhe Kosova do të kërkojnë kualifikimin historik në një kampionat evropian.



Berisha i ka dy fjalë për Kosovën

Valon Berisha thotë se barazimi i Kosovës me Ishujt Faro nuk ishte rezultat i keq. Futbollisti kosovar thotë se më e rëndësishmja është se Verdhekaltrit vazhdojnë të prijnë në grupin e tyre në Ligën e Kombeve. "Ne u munduam të fitonim kundër Ishujt Faro, por barazimi është i mirë po ashtu. Ne jemi në krye të grupit. Fatkeqësisht, kundërshtari ynë u mbyll dhe ishte e vështirë të shënonim", ka thënë përfaqësuesi kosovar në konferencë për shtyp. Berisha është rikthyer tek Lazio dhe beson se shpejt do ta kthejë formën ideale, të cilën e gëzonte para lëndimit.

Në bazë të nenit 1 paragrafi 22 1 dhe 3 , nenit 23 paragrafi 1,4,5 të Ligjit për marrëdhënie pune („Gazeta zyrtare e RM, nr. 62/05,106/08,161/08,114/09,130/09,120/11,10/12,11/12,13/13,25/13,170/13,187/13,113/14,20/15,33/15,72/15, 129/15 i 27/16) nenit 82 të ligjit për arsim të lartë (" Gazeta zyrtare e RM " nr.103/08,33/10,156/10,18/11, 51/11,6/12,100/12,24/13,41/14,116/14,135/14,10/15 , 98/15145/15 ,30/2016,127/16 dhe 67/17) dhe pajtueshmërisë së MF nr. 18-10397/2 prej 28.09.2018 dhe MASH Nr. 12-10071/4 prej 09.10.2018 , drejtori SH.F.,Draga Stojanovska,,f.Rakotinci-Sopishte , solli

SHPALLJE

për punësim me kohë të caktuar, financim i vjetër për vitin shkollor 2018/2019

1. Një mësimdhënës për 12 orë mësimore për realizimin e mësimdhënies në biologji - 4 orë, kimi -2 orë, gjeografi -2 orë dhe lëndët zgjedhore të shkathësisë të jetesës për 2 orë, gjuha turke në PU në f. Drzhilovë në paralele të kombinuara, me një pagë bazë neto prej 13,005.00 denarë, për një kohë të caktuar për vitin shkollor 2018/2019, deri më 31.08.2019.

2. Një mësimdhënës për 13 orë mësimore për mësimdhënie në matematikë - 9 orë, Fizika -2 kohë dhe lëndë zgjedhore kultura klasike e qytetërimit evropian për 2 orë, në gjuhën turke në PU në f. Drzhilovë në paralele të kombinuara, me pagën bazë neto prej 14,089.00 denarë, për kohën e caktuar për vitin shkollor 2018/2019 deri më 31.08.2019.

Përveç kushteve të përgjithshme të përcaktuara nga Ligji për Marrëdhënie Pune, kandidatit për mësimdhësin duhet të plotësojë edhe këto kushte të veçanta sipas neneve 80 dhe 81 të Ligjit për Arsimin Fillor: të jenë shtetas i Republikës së Maqedonisë, të kenë arsim adekuat, të njohë gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik (në paralelet turke dhe gjuhën dhe alfabetin në të cilin kryen mësimdhënien) dhe të ketë kaluar provimin profesional për mësues, një bashkëpunëtor profesional apo për një edukator.

Në shpalljen publike mund të aplikojë edhe një person pa provimin e dhënë profesional , dhe të krijojë një marrëdhënie pune me një kohë të caktuar të punës deri në fund të vitit shkollor.

Orari i punës së mësuesit gjatë javës së punës pesë ditore do të kryhen në ndërrimin e parë duke filluar nga ora 08:00 në përputhje me planin mësimor për vitin shkollor 2018/2019.

Shpallja zgjat 5 ditë pune nga dita e publikimit të tekstit të shpalljeve në gazetata ditore.

Zgjedhja do të kryhet jo më vonë se 15 ditë pas shpalljes.

Kërkesa për punësim së bashku me CV-në dhe dëshmitë e nevojshme për plotësimin e kushteve të nevojshme duhet t'i dorëzohen SH.F "Draga Stojanovska" f. Rakotinci –Sopishte në adresën rr.,, 1 ,, nr. 2A f. Rakotinci-Sopishte .

SH.F "Draga Stojanovska"

F.Rakotinci -Sopishte

LAJMËRIM

Shoqëria për ndërtim, menaxhim dhe dhënie me qira të sallës për shumë qëllime BORIS TRAJKOVSKI SHPKNJ Shkup Ju njofton se ANULOHET SHPALLJA e botuar nr. 01/2018 për shfrytëzimin e Vip Arenës në kompleksin e Qendrës sportive BORIS TRAJKOVSKI në Shkup për vendosjen e banakëve në "NOVA MAKEDONIJA" me datë 16.10.2018 dhe në "KOHA" me datë 16.10.2018 dhe korrigjimin e të njëjtës shpallje të botuar në "NOVA MAKEDONIJA" me datë 17.10.2018 dhe në "KOHA" me datë 17.10.2018 në pajtim me Vendimin e pruar për ndalim të vazhdimin të Vendimit për shfrytëzim të hapësirës së Vip Arenës në kompleksin e Qendrës sportive BORIS TRAJKOVSKI në Shkup për vendosjen e banakëve (e regjistruar me nr. ark. 02-258/7)

Në bazë të nenit 30 të Statutit të EPSH Klinika Universitare për kirurgji plastike dhe rikonstruive Shkup, në lidhje me nenin 156, 157 paragrafi 1 alinea 1, 158, 159, 160 paragrafi 3 nga Ligji për mbrojtje shëndetësore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë) nr. 43/2012, 145/2012, 87/2013, 164/2013, 39/2014, 43/2014, 132/2014, 188/2014, 10/2015, 61/2015, 154/2015, 192/2015, 17/2016 u 37/2016,u.d Drejtori I Klinikës publikon

SHPALLJE PUBLIKE

Për punësim në kohë të pacaktuar EPSH Klinika Universitare për kirurgji plastike dhe rikonstruive Shkup ka nevojë për

- 10 (dhjetë) perona – motra medicinale për kohë të pacaktuar
 1. Dokumentet e nevojshme
- lutje,(me adresë të saktë të banimit dhe numër telefoni) me shënim për shpalljen publike
- biografi të shkurtër (CV)
- vërtetim shtetësisë të RM (origjinal apo kopje e vërtetuar në notar)
- vërtetim për aftësinë e përgjithshme shëndetësore (mos të jetë më e vjetër se 6 muaj)(origjinal apo kopje e vërtetuar në notar)
- vërtetim se nuk i është shqiptuar vendim i plotfuqishëm gjyqësor për ndalesë të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë apo detyrës (të mos jetë më e vjetër se 6 muaj) (origjinal apo kopje e vërtetuar në notar)
- dëshmi se ka të kryer Shkollën e mesme medicinale (SHMM) për motër medicinale dhe at të gjitha 4 (katër) dëftesat ku është shënuar suksesi për kryerjen e katër viteve të SHMM pë çdo vit eçmas (origjinal apo kopje e vërtetuar në notar)
- vërtetim se ka të kryer provimin profesional (origjinal apo kopje e vërtetuar në notar)
- certifikate se e njeh punën me programet kompjuterike për punë në zyrë (origjinal apo kopje e vërtetuar në notar)

2. Afati i paraqitjes është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes publike.

3. Dokumentet dorëzohen në arkivin e Klinikës në adresën e EPSH Klinika Universitare për kirurgji plastike dhe rikonstruive Shkup rruga. Vodnjanska nr.17, Shkup, me shënim : ,, për shpalljen publike dhe vendin e punës që konkurron

Orari i punës 40 orë në javë dhe paga mujore bazë për kandidatët motra medicinale është 18.800,00 denarë.

EPSH KLINIKA UNIVERSITARE PËR KIRURGJI PLASTIKE DHE RIKONSTRUIVE SHKUP

Korigjim i SHPALLJES PUBLIKE 221/2018 AGJENCIA PËR ADMINISTRATË

Bëhet korrigjim i shpalljes publike nr. 221/2018, publikuar më 18.10.2018, për Fondin e Sigurimit Shëndetësor të Maqedonisë, në vendin e punës nr.1 FZO0102B01002 Këshilltar i drejtorit, në pjesën e kushteve të posaçme pas fjalës „të kryer shkallën VII/1” shtohen fjalët “Shkencat e Mjekësisë, Stomatologji, Shkenca ekonomike”.

Në bazë të neni 22, paragrafi 1, pika dhe neni 23 nga Ligji për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 145/14 – tekst i pastruar), Rregullores për sistematizim të vendeve të punës për IN Qendra kombëtare e konservimit – Shkup (nr. 01-233/2 nga viti 18.05.2018), me Pëlqimin e Ministrisë së Financave (nr 18-10558/2 nga viti 28.09.2018) dhe në pajtim me nenin 14, paragrafi 1, pika 6 e Statutit të IN Qendra kombëtare e konservimit – Shkup, publikon

SHPALLJE PUBLIKE

për pranimin e tetë (8) personave në afat të pacaktuar për shtatë (7) vende të punës

Publikohet thirrje publike për pranimin e tetë (8) personave në afat të pacaktuar. Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune duhet ti plotësojnë edhe kushtet e posaçme edhe atë për këto vende të punës:

1) Bashkëpunëtor profesional për përpunimin e dokumentacionit PLP apo me arritjen e 240 kredive në bazë të EKTS-histori e artit, arkeologji, arkitekturë- një (1)

- me apo pa përvojë pune
Orari ditor i punës nga ora 08:00 deri në ora 16:00, orari javor i punës nga e hëna deri të premtën 40 orë, neto rroga bazë 19,302.00 denarë

2) Konservues bashkëpunëtor Profesional për trashëgimi arkitektonike me PLP apo me arritjen e 240 kredive sipas EKTS nga arkitektura, urbanizmi dhe planifikimi – dy (2) persona

- me apo pa përvojë pune
Orari ditor i punës nga ora 08:00 deri në ora 16:00, orari javor i punës nga e hëna deri të premtën 40 orë, neto rroga bazë 19,532.00 denarë

3) Konservues bashkëpunëtor Profesional për statistikë me PLP apo të fituara 240 kredive sipas EKTS nga arkitektura, urbanizmi dhe planifikimi – një (1) person

- me apo pa përvojë pune
Orari ditor i punës nga ora 08:00 deri në ora 16:00, orari javor i punës nga e hëna deri të premtën 40 orë, neto rroga bazë 19,532.00 denarë

4) Konservues bashkëpunëtor Profesional për trashëgimi arkeologjike me PLP apo të fituara 240 kredive sipas EKTS nga historia e artit/arkeologjisë- një (1) person

- me apo pa përvojë pune
Orari ditor i punës nga ora 08:00 deri në ora 16:00, orari javor i punës nga e hëna deri të premtën 40 orë, neto rroga bazë 19,532.00 denarë

5) Konservues bashkëpunëtor Profesional për trashëgimi të artit me PLP apo të fituara 240 kredive sipas EKTS nga historia e artit/arkeologjisë – një (1) person

- me apo pa përvojë pune
Orari ditor i punës nga ora 08:00 deri në ora 16:00, orari javor i punës nga e hëna deri të premtën 40 orë, neto rroga bazë 19,532.00 denarë

6) Konservues bashkëpunëtor Profesional për konservim të artit mural me PLP apo të fituara 240 kredive sipas EKTS nga arti vizatimor – një (1) person

- me apo pa përvojë pune
Orari ditor i punës nga ora 08:00 deri në ora 16:00, orari javor i punës nga e hëna deri të premtën 40 orë, neto rroga bazë 19,975.00 denarë

7) Konservues bashkëpunëtor Profesional për konservim të mozaikut me PLP apo të fituara 240 kredive sipas EKTS nga arti vizatimor- një (1) person

- me apo pa përvojë pune
Orari ditor i punës nga ora 08:00 deri në ora 16:00, orari javor i punës nga e hëna deri të premtën 40 orë, neto rroga bazë 19,975.00 denarë

Vërejtje: Deri sa të zgjatë stazhi përgatitor, realizuesve stazhistë paga themelore do tu përcaktohet në pajtim me ligjin dhe marrëveshjen kolektive.

- Kandidatët së bashku me fletëparaqitjen duhet të dorëzojnë:

- Biografi të shkurtër;
- Certifikatë për arsim të mbaruar përkatës, të vërtetuar në noter;
- Certifikatë të shtetësisë, (fotokopje);
- Kopje të letërnjoftimit.

Shpallja publike zgjatë 5 (pesë) ditë pune nga dita e publikimit të fundit.

Zgjedhja do të bëhet në afat prej tetë (8) ditë pune pas kalimit të afatit për paraqitje në shpalljen publike

Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh.

Fletëparaqitjet me dokumentacion të kompletuar të dorëzohen përmes postës në zarf të mbyllur me shenjë “Për shpalljen për punësim” deri tek Institucioni nacional, Qendra konservatore – Shkup, rr. “Josif Mihajloviq” nr. 7, Fahu postal 225, Shkup ose në arkivin e institucionit, çdo ditë pune.

IN Qendra nacionale konservatore – Shkup

Në bazë të nenit 37 nga Ligji për Ndërmarrjet Publike, neni 20 nga Ligji për të punësuarit në sektorin publik neni 22 dhe neni 23 nga Ligji për marrëdhënie pune dhe Pëlqimi i Kryetari të Komunës së Ohrit, dr. Jovan Stojanoski nr. 09-14525/2 nga viti 16.10.2018, Drejtor I NP NISKOGRADBA OHËR, Ohër e publikon

THIRRJEN PUBLIKE për pranin të punëtorëve në afat të pacaktuar

NP NISKOGRADBA OHËR-Ohër publikon thirrje publike për punësimin e 3 (tre) personave ndihmës-technikë për pozicionet vijuese:

1.KDR 04 01 A03 012, Punëtor i thjeshtë – 3 (tre) përmbarues

Kandidatët duhet ti plotësojnë këto kushte:

Kushte të përgjithshme:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- në mënyrë aktive ta fletë gjuhën maqedone,
- të jetë i ritur dhe
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës.

Kushte të posaçme:

- Shkollimin fillor

Kandidatët për punësim paraqiten në thirrje publike përmes plotësimit të fletëparaqitjeve dhe parashtrimit të provave për plotësimin e kushteve për vendin e punës. Fletëparaqitjen për punësim kandidatët mund ta marrin në NP NISKOGRADBA OHËR-Ohër..

Me fletëparaqitjen kandidatët në formë origjinale apo të notuar duhet ti dorëzojnë edhe:

- Provat për aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Provë për përfundimin e shkollimit

Thirrja publike zgjatë 5 ditë nga dita e shpalljes së tij në shtypin ditor. Fletëparaqitjet e pakompletuar dhe të dorëzuara pas afatit kohor, përfshi edhe dokumentet nuk do të shqyrtohen. Fletëparaqitjen me dokumentet e plota kandidatët mund ta dorëzojnë personalisht në arkivin e Ndërmarrjes Publike, deri në ora 15:00 të ditës së fundit apo përmes postës përmes zarfit të mbyllur me titull “Për thirrjen” në adresën NP NISKOGRADBA OHËR-Ohër, rruga Zeleniça pn, 6000 Ohër

NP NISKOGRADBA OHËR-Ohër

**Drejtor,
Besnik Osmani**

Në bazë të nenit 22, paragrafi 1, pikat 1 dhe 23 të Ligjit të Punës, Gaz. Z. 167/15, të nenit 79 të Ligjit për Arsimin Fillor, nenit 6 të Ligjit për Punëtorët e Sektorit Publik, Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës dhe pëlqimin e Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 12-1038 / 1 SH.F .Braka Ramiz-Hamid - Shuto Orizare, Shkup publikon :

SHPALLJE PUBLIKE 04-228

Shkolla Fillore Braka Ramiz-Hamid - Komuna Shuto Orizare, Shkup ka nevojë për themelimin e marrëdhënies së punës për kohë të pacaktuar për vendet e mëposhtme të punës :

Numri 1 Niveli A1 002. Shifra OBN 04 A01 001 pastrues shtatë (7) realizues me arsim fillor ose të mesëm të mbaruar me pagë bazë prej 12.165,00 denarë.

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet e përgjithshme të parapara me Ligj.

Kushte të veçanta: me dhe pa përvojë pune

Orari i punës:

-Ditët e punës nga e hëna deri të premtën, orët e punës në javë 40, orari i punës në ndërrimin e parë nga ora 06.00 deri në orën 14.00 dhe në ndërrimin e dytë nga ora 12.00 deri në orën 20.00.

• Shpallja zgjat 3 ditë pune, duke llogaritur nga dita e publikimit në shtypin ditor.

• Zgjedhja pas shpalljes do të bëhet brenda 45 ditëve, gjegjësisht 90 ditë pas mbylljes së përfundimit të shpalljes, varësisht nga numri i aplikantëve të paraqitur.

Lutjet me dokumentet e nevojshme duhet të dorëzohen në SHF "Braça Ramiz-Hamid" - Shuto Orizare, Shkup, rr. "Çe Gevara" nr. 80 Tel. 02 2654-040,

U.D Drejtori
Alvin Salimovski

PEREZ ZGJEDH TRAJNERIN E RI, NËSE IKËN LOPETEGUI

Durimi i presidentit Florentino Perez duket se ka sosur, ai i ka dhënë kohë trajnerit të vet të reagojë. "El Clasico" me Barcelonën do të jetë shansi i fundit për Lopetegui. Sidoqoftë, kreu i "Los Blancos" është duke menduar për një zëvendësues, që të mos zihet në befasi. Emri që lakohet më shumë nga mediat italiane është ai i Antonio Contes.



humbur "frerët" e një ekipi me cilësi të mëdha, që nga ndeshja në ndeshje demonstroi se e ndien shumë largimin e pesë herë fituesit të "Topit të Artë". Durimi i presidentit Florentino Perez duket se ka sosur, ai i ka dhënë kohë trajnerit të vet të reagojë. "El Clasico" me Barcelonën do të jetë shansi i fundit për Lopetegui. Sidoqoftë, kreu i "Los Blancos" është duke menduar për një zëvendësues, që të mos zihet në befasi. Emri që lakohet më shumë nga mediat italiane është ai i Antonio Contes. Ky i fundit është pa punë, pasi ka lënë prapa kraheve një divorc mjaft kompleks me Chelsea, klub i cili në fund vendosi të përqëndrohet te Maurizio Sarri. Siç është shpallur nga "Corriere dello Sport", ish-trajneri i Italisë është kontaktuar me telefon të hënën nga

kryeqyteti spanjoll. Situata ka ndryshuar nga disa muaj më parë, kur Conte nuk mund të thoshte "po". Tani, trajneri italian do të pranojë, duke ofruar gatishmërinë e tij për t'u ulur në stolin e një prej klubeve më prestigjioze në historinë e futbollit. Sigurisht, një sy i mprehtë shkon te ndeshjet e ardhshme, vendimtare për të ardhmen e Lopetegui: ajo në shtëpi me Levante, udhëtimi në Plzen, për të luajtur me Viktoria dhe, mbi të gjitha, "El Clasico" në Barcelonë. Ky kalendar ndeshjesh do të vendosë, me çdo probabilitet, fatin e ish-trajnerit të Spanjës në "Santiago Bernabeu". Në rastin e dështimeve të tjera, largimi i Lopetegui do të ishte zgjidhja më e mirë dhe e nevojshme, e cila do t'i hapte rrugën rikthimit të Antonio Conte në trajning.



Buffon: Mbappe më ngjason me këto tri yje të futbollit italian

Portieri i PSG-së, Gianluigi Buffon, ka mbështetur shokun e tij të skuadrës, Kylian Mbappe, për të fituar "Topin e Artë", viti 2018. Mbappe u përzgjedh ndër 30 finalistët për këtë çmim prestigjioz individual, pas paraqitjes mahnitëse në këtë vit kalendarik, kur udhëhoqi PSG-në në një sukses të trefishtë vendas (në Ligue 1) dhe Francën në fitimin e Kupës së Botës (në Rusi). 19-vjeçari fitoi çmimin e lojtarit të ri më të mirë në Kupën e Botës së kësaj vere, pasi shënoi katër gola në turne, duke përfshirë një gol në finalen kundër Kroacisë. Dhe Mbappe e ka ruajtur ritmin e lartë të të luajturit në sezonin 2018-2019, deri më tani, duke shënuar 10 gola në vetëm shtatë ndeshje për PSG-në. Shumë kanë thënë se Mbappe do të fitojë "Topin e Artë" në të ardhmen, por Buffon beson se "adoleshenti" ka mundësi ta bëjë këtë që këtë vit. "Duke pasur parasysh cilësitë e tij, atë që tregon në fushë dhe sa vendimtar ishte gjatë Kupës së Botës, ai e meriton atë trofe. Nuk mund të them të kundërtën", tha Buffon në emisionin televiziv francez "Tout le Sport". Kur u pyet nëse kishte takuar një talent të tillë, Buffon iu përgjigj: "Në Itali, ai mund të krahasohet me Roberto Baggio, Alessandro Del Piero dhe Francesco Totti. Por, Mbappe ka një talent të jashtëzakonshëm dhe cilësi teknike, që i kam parë rrallë. Është një fenomen dhe, nëse vazhdon të dëshirojë të jetë më i miri, nëse vazhdon të jetë entuziast dhe e ruan sjelljen e tij normale, mund të mbizotërojë shumë kohë në majat e futbollit".

Publicitet

Në pajtim me nenin 34 paragrafi 4 e Ligjit për arsim fillor dhe Rregulloren për realizimin e ekskursioneve për nxënës dhe aktivitetet tjera të lira nr. 07-9992/2 të datës 05.06.2014 shkolla "Dame Gruev" Kuklish komuna e Strumicës publikon

SHPALLJE

Për realizimin e:

1. Ekskursion treditor nëpër Maqedoni për nxënësit e klasës së IX (nëntë)
2. Ekskursion dyditor nëpër Maqedoni për nxënësit e klasës së VI (gjashtë)
3. Ekskursion njëditor nëpër Maqedoni për nxënësit e klasës së III (tretë)

4. Mësim në natyrë për nxënësit e klasës së V (pesë).

-Ekskursionet do të realizohen përmes grumbullimit të ofertave.

Të drejtë për pjesëmarrje kanë ofertuesit të cilët:

*janë të regjistruar për kryerje të veprimtarisë turistike,

*në mënyrë të suksesshme kanë realizuar së paku tri ekskursione për nxënës,

*përbushë kushtet për transport në pajtim me Ligjin për siguri në komunikacion,

*të sigurohet mjek

*Ekskursionet janë me program të posaçëm që mund të merret nga Komisioni për grumbullimin e ofertave

-Kriter për marrje të ekskursionit është oferta më e volitshme ekonomike.

Shpallja zgjatë 5 ditë nga dita e publikimit të shpalljes në shtypin ditor.

SHFK "Dame Gruev" Kuklish
Drejtor
Valentina Pelivanova



Ministria e mjedisit jetësor dhe planifikimit të mjedisit e R. Maqedonisë

SHPALL

Kërkesë për dhënie e Lejes për shfrytëzimin e ujit të pusit për nevoja industriale, teknologjike dhe ekonomike "BABTEK MZT", SHA Shkup, pusi gjendet në KP1125/1KO Maxhari, komuna Gazi Babë. Sipas nenit 30 paragrafi 1 të Ligjit për ujërat (Fletorja zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 87/08, 09/09, 161/09, 83/10, 51/11, 44/12, 163/13, 180/14, 146/15 dhe 52/16), deri tek Ministria mjedisit jetësor dhe planifikimit të mjedisit është parashtruar Kërkesë për dhënie e Lejes për shfrytëzimin e ujit të pusit për nevoja industriale, teknologjike dhe ekonomike, pusi gjendet në KP1125/1KO Maxhari, komuna Gazi Babë.

Parashtruesi i kërkesës:

"Babtek MZT" SHA Shkup
Rr. Pero Nakov, nr. 124, 1000 Shkup

Koordinatat e shfrytëzimit të pusit B-1 KP1125/1 KO Maxhari, komuna Gazi Babë.

Pusi X-4650264.32 dhe Y-7540706.67.

Informacionet në lidhje me kërkesën opinionin i interesuar mund t'i marrë pranë Ministrisë së mjedisit jetësor dhe planifikimit të mjedisit, e-mail H.Rexhepi@moepp.gov.mk
Opinionin i interesuar, në një afat prej 15 ditësh, nga dita e publikimit të kërkesës, ka të drejtë që të parashtrorë sugjerime dhe komente në formë të shkruar pranë Ministrisë së mjedisit jetësor dhe planifikimit të mjedisit, bulevardi "Goce Dellçev", nr. 18 godina e RTM (kati 10), 1000 Shkup.

LAJMËRIM

Për anulum të Konkursit publik

Konkursin publik për pranim të zjarrfikës profesionistë në marrëdhënie të rregullt pune nw TPPE Sveti Nikolee anulohet për shkak të gabimit teknik në tekst. Pas korigjimit të tekstit do të publikohet enkas.

Komuna e Sveti Nikoles
Kryetari i Komunës,
M-r Sasho Vellkovski

MIRATIMI

për akcizë-shfrytëzim të autorizuar të mallrave me akcizë
-RREGJISTRIM-

me numër: 4007005132974 të datës 29/10/2009.
e dhënë në emër të: SPITALI I PËRGJITHSHËM I.P.SH.
GOSTIVAR,
shpallet e pavlefshme

URGJENTISHT

Shitet shtëpi në lagjen Serava-Shkup në rr. "7 korriku" nr. 8 afër spitalit gjinekologjik, shtëpia është e ndërtimit të ri me dokumentacion të kompletuar. Kontakt tel. 071 372 221

Shitet tokë e cila gjendet në Shkup, f. Gerqec, edhe atë;
-PK 997, vendi i quajtur Murishta, me sipërfaqe prej 1372m2, e regjistruar ne Flet pronësi nr. 221per KK Gërqec, pronësi e Ramiz Ademit.

Të interesuarit dhe të gjithë ata që kufizohen me parcelën në fjalë, ofertat e tyre mund ti paraqesin në zyrën e Noterit Mahir Ziberit, rr. Butelska nr. 4, Shkup-Butel.



KOHA E VËRTETË PËR ASTRA SEDAN



1.6 Benzin, 115KF

13.390€

opel.mk

 E ARDHMAJA I
TAKON TË GJITHËVE

Pamja e paraqitur e veturës është vetëm për ilustrim dhe nuk ka të bëjë me këtë promovim. Opel Southeast Europe LLC dhe shitësit e autorizuar e mbajnë të drejtën e ndryshimit dhe tërheqjes së ofertës në cilën do kohë dhe pa asnjë paralajmërim. Për më tepër informacion kontaktoni shitësit e autorizuar të Opelit. Oferta vlen deri më datë: 31.12.2018

Auto CEM 044 353 330

Automakedonija 02 310 31 30

Në bazë të nenit 114 dhe nenit 176 të Ligjit për arsim sipëror ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 82/2018), Dekani i Fakultetit filozofik pranë Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup, publikon

KONKURS

- Për zgjedhje të një (1) mësimitshkencor në të gjitha titujt mësimitshkencor nga sferat mësimore-shkencore: Historia e mesjetës (60103), Historia Kombëtare e Mesjetës (60111), Bizantogjia (60104) dhe Arkivimi dhe Dokumentimi (60303), për kohë prej 5 (pesë) vjet.

Krahas kushteve të përgjithshme kandidatët duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme të përcaktuara me nenin 164, dhe nenin 166 të Ligjit për arsim sipëror (Gazeta Zyrtare e R. Maqedonisë nr. 82/18), dhe akteve të tjera të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe Fakultetit filozofik në Shkup.

Me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë:

- biografi të shkurtër (CV), me fotokopje të vendimit për zgjedhje në titujt mësimore-shkencore, nëse kanë zgjedhje të mëparshme në titujt mësimore-shkencore
- dëshmi për shkallën e arritur përkatëse të arsimit – doktor i shkencave nga sfera shkencës për të cilën zgjedhen,
- certifikatë të shtetësisë,
- deklarata për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës listë të punimeve të publikuara shkencore dhe profesionale, nga një kopje prej punimeve,
- dëshmi për gjendjen e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- dëshmi se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës,

Zgjedhja e kandidatëve bëhet në pajtim me Ligjin për arsim sipëror dhe aktet tjera të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup dhe Fakultetit filozofik në Shkup.

Orari i punës së mësimitshkencor në titullin mësimitshkencor është caktuar në pajtim me aktet e Fakultetit filozofik. Bruto pagesa fillestare e mësimitshkencor është rreth 56.294,00 denarë.

Procedura e konkursit për zgjedhje në titujt mësimitshkencor dhe bashkëpunues zgjat më së shumti 6 muaj duke konsideruar nga dita e publikimit të konkursit.

Dokumentet parashtrihen në Fakultetin filozofik në Shkup, bul. Goce Dellçev nr. 9A, 1000 Shkup, në afat prej 8 ditëve nga dita e publikimit të Konkursit në shtypin ditor.

Informata plotësuese mund të merren në numrin e telefonit 02 3116-520

Në bazë të nenit 114 paragrafi 4 pika 7 të Ligjit për arsim të lartë,

Fakulteti teknik – Manastir

Publikon

KONKURS
për zgjedhje të mësimitshkencor

Shpallet konkurs për zgjedhje të një mësimitshkencor në të gjitha titujt mësimitshkencor nga sfera Mekanika klasike (10313) për kohë prej 5 vite.

Kandidatët duhet ti plotësojnë kushtet e përgjithshme në pajtim me Ligjin për arsim të lartë dhe kushtet e veçanta në pajtim me Rregulloren për kriteret e vetme dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimitshkencore, mësimitshkencore-profesionale, mësimitshkencore dhe bashkëpunuese në universitetin "Shën Kliment Ohridski" - Manastir.

Fillimi, mbarimi dhe orari i punës dhe shuma e të hollave të pagesës (në bruto shumë: 43.184,00 den., 46.534,00 den., 51.310,00 den.) për mësimitshkencor janë të ndryshueshme dhe përcaktohen në pajtim me aktet e Fakultetit sipas orarit të mësimit në semestër, angazhimit dhe titullit në të cilin është zgjedhur mësimitshkencor (docent, profesor i pavarur, profesor i rregullt).

Kandidatët për zgjedhje në titujt mësimitshkencor së bashku me fletëparaqitjen duhet të dorëzojnë edhe: certifikatë të lindjes, biografi, dokument për arsim të arritur, listë të punimeve shkencore dhe profesionale dhe nga një kopje prej të njëjtave.

Fletëparaqitjet do të dorëzohen përmes postës në adresën: Fakulteti teknik – Manastir, rr. "Makedonska fallanga" 33, ose në arkivin e Fakultetit teknik – Manastir në afat prej 8 ditëve nga dita e publikimit.

FAKULTETI TEKNIK – MANASTIR

 REPUBLIKA E MAQEDONISË
AGJENCIA E ADMINISTRATËS

Në bazë të nenit 35 të Ligjit të Nëpunësve Administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 48/15, 154/15, 5/16, 142/16 dhe 11/18) dhe Rregullores së mënyrës së zbatimit të procedurës për punësim të nëpunësve administrativë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/18), lidhur me nenin 20-g të Ligjit të punësuarve në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 27/14, 199/14, 27/16 dhe 35/18) dhe Rregullores së elementeve të obligueshme të shpalljes publike të plotësimit të vendit të punës në sektorin publik përmes punësimit dhe fletëparaqitjes për punësim, si dhe të formës, përmbajtjes dhe mënyrës së mbajtjes së regjistrimit të personave që kanë dhënë të dhëna të rrejtshme gjatë punësimit në sektorin publik („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 34/15), Agjencia e Administratës publikon

SHPLLJE PUBLIKE NUMËR – 225/2018

për punësimin e 1 nëpunës publik nga grupi I, nëngrupi II në „Shkollën Filllore Komunale Vera Ciriviri-Trena Komuna e Karposhit” për vendet e punës në vijim:

- OBN0102V01001 Këshilltar për punë të përgjithshme dhe normative juridike - Sekretar, Njësia I realizues(ë)

për punë normative - juridike, burime njerëzore dhe punë të përgjithshme, Shërbimi Administrativ

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- Ta njohë mirë gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës madhore,
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës,
- Me vendim gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerjen e profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kushtet e posaçme:

- niveli i kualifikimeve VI A sipas kornizës maqedonase të kualifikimeve dhe së paku 240 kredi sipas ECTS, ose të kryer shkallës VII/1, Fakulteti juridik
- së paku 3 (tre) vjet përvojë pune në profesion

Kompetencat e përgjithshme:

- zgjidhje të problemeve dhe marrje të vendimeve për çështje të sferës së tij
- mësim dhe zhvillim
- komunikim
- arritje të rezultateve
- puna me të tjerë/puna ekipore
- ndërgjegjësim strategjik
- orientim kah palët/palët e interesuara; dhe
- menaxhim financiar

Kompetenca të posaçme:

- njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë
- njohje aktive të një prej gjuhëve më të folura të Bashkimit Evropian (anglisht, frengjisht, gjermanisht)

Orari i punës :

- Ditët e punës e hënë - e premte
- Orët javore të punës 40
- Orari ditor i punës 07:00 - 15:00
- Rroga neto: 21.676,00 denarë

VËREJTJE: Sipas planit vjetor për punësim në institucionin përkatës për vitin 2018 janë të parapara: Maqedonas(e) 1.

Kushtet e lartpërmendura në shpallje kandidatët duhet t'i plotësojnë në momentin e aplikimit në formë elektronike nëpërmjet profilit të përdoruesit të krijuar në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Afati i aplikimit zgjatet 15 ditë, duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes. Pas mbarimit të afatit për aplikim, shpallja do të jetë e larguar nga faja e internetit e Agjencisë.

Pas kalimit të afatit të aplikimit, shpallja do të jetë e hequr nga faja e internetit e Agjencisë.

Kandidatëve u kërkohet fletëparaqitjen ta plotësojnë në tërësi, të jenë precizë dhe të japin të dhëna të sakta. Kandidatët e paraqitur në shpalljen publike në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës do të informohen, për kohën dhe vendin e mbajtjes së çdo faze të ardhshme të procedurës për selektim të nëpunësit administrativ.

Faza e 1 – rë: selektimi administrativ realizohet në një afat prej 15 ditësh pas mbarimit të shpalljes së publikuar.

Faza e 2 – rë: provimi i nëpunësit administrativ realizohet në një afat jo më të shkurtër se 10, dhe jo më të gjatë se 30 ditë pas mbarimit të fazës së 1 – rë. Ai inçizohet dhe emetohet drejtpërdrejtë në faqen e internetit të Agjencisë së Administratës.

Faza e 3 – rë: kontrollimi i vërtetësisë së provave dhe intervista realizohet në një afat prej 10 ditësh pas mbarimit të fazës së 2 – rë.

DASHI 21. mars - 20. prill
Do të merrni një lajm të mirë, i cili do ju bëjë tejet euforik, sidomos nëse jeni të përfshirë në një projekt të rëndësishëm. Gjatë kësaj dite duhet të jeni më të dashur dhe të pranishëm në familje ose në raportin në çift.

DEMI 21. prill - 21. maj
Do të ndjeni dëshirën për të dalë nga rutina juaj, sidomos nëse nuk jeni plotësisht të kënaqur me aktivitetet me të cilat po merreni. Nëse jeni në prag të nisjes së një projekti të ri, kërkonini më shumë mbështetje nga ana e familjes.

BINJAKET 22. maj - 21. qershor
Do të keni mundësi që të merrni konfirmime të rëndësishme në punë dhe kjo gjë do ju japë më shumë liri dhe përgjegjësi. Duhet të jeni të hapur ndaj një ballafaqimi, pasi mund të zbuloni strategji interesante për të përmirësuar të gjithë projektet tuaja. Në dashuri do të jeni konfuz.

GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik
Duhet të mbështeteni tek bashkëpunëtorët tuaj dhe të mbyllni një negociatë të rëndësishme. Do ta gjeni veten mjaft të kënaqur. Diskutoni çdo dyshim, para se të merrni vendime të rëndësishme.

LUANI 23. korrik - 22. gusht
Jini optimist pasi do të keni çdo gjë që ju duhet për të arritur objektivat tuaja. Lini mënjatë krenarinë dhe frikën se mos gaboni, dhe jini më të pranishëm në dashuri.

VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator
Parashikohet një ditë mjaft intensive e cila do ju sjellë një sërë frytësh. Këshillohet që të mos jeni shumë impulsiv në dashuri, ose në të kundërt rrezikoni që të vini në vështirësi partnerin/en.

PESHORJA 24. shtator - 23. tetor
Jeni në një fazë rebelimi, ku do të vini në diskutim çdo pikëpamje të jetës suaj. Duhet jeni të fortë dhe kjo gjë do ju ndihmojë si në punë edhe në dashuri. E enjtja favorizon mjaft takimet.

AKREPI 24. tetor - 22. nëntor
Shpesh prireni që të jeni shumë të tensionuar ndaj kundërshtive me të cilat haseni, por në këtë moment është e rëndësishme të mos përfshihen nga paniku. Intuita e mirë do ju vijë në ndihmë. Dashuria do të jetë një sektor mjaft i favorizuar gjatë kësaj dite.

SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor
Do të mbeten të befasuar nga sjellja e një kolegu tuaj. Motivimi i bashkëpunëtorëve është mjaft i rëndësishëm, për të ruajtur një klimë produktive dhe të qetë. Në dashuri do të jeni në kërkim të më shumë qetësie.

BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar
Kjo ditë do ju gjejë në humor shumë të mirë dhe do të jetë ky pozitivitet ai që do të favorizojë të gjitha takimet tuaja. Këshillohet që të jeni më kurajoz dhe të pavarur në vendin e punës. Rifutja në lojë do ju dhurojë një sërë mundësish të frytshme.

UJORI 21. janar - 19. shkurt
Këshillohet që të rishikoni mënyrën tuaj të sjelljes. Kjo pasi sjellja juaj do të ndikojë lidhur me takimet apo negociatat e rëndësishme që duhet të çoni deri në fund.

PESHQIT 20. shkurt - 20. mars
Do të ndiheni të lënë pas dore dhe për këtë arsye do të jeni në kërkim të pikave të reja të referimit. Mos u përfshini në aventura të reja për ndjenjat tuaja, pasi në këtë moment do të jeni shumë emotiv dhe nervoz.

Mensur Mamuti	KËNGËTARJA AMERIKANE E 80AVE, NË FOTO	KIMISTE GJERMANE, TAKE	KËNGË E KËNGËTARES NË FOTO	KËNGËTARJA JONE, RITA	RRIP METALI PER MBYLLJEN E DERËS					
GJITAR										
MENAXHIM (TUR.)										
FALJE PESE HERË NË DITË										
POLITIKANIA KOSOVARE, ZHUPA				ENERGJIA	KLUB ITALIAN					
ZBRAZ DIÇKA NGA NJË ENË NË NJË TJETER										
KOMUNË NË FRANCË						MPIKSJA E GJAKUT (SH. PASHQ.)				
MELIHATE AJETI			TEFTA TASHKO							
LLOJ ËMBËLSIRE			VJEDHËSI KUSARI							
LITRI		ARMY RESEARCH OFFICE				KËRCELLI I HOLLË I BIMËS, FILZI	ENERGJIA	KËNGË E KËNGËTARES NË FOTO	MOHIM	EMËRTIM QË MERRËT SIPAS DIÇKAHIT
OPEN-ACCESS NETWORK		ELEMENT KIMIK								
NJËSI E MATJES SË ELEKTRICITETIT				KUSUR, MBETURINË	TITULL FEUDAL BORGJEZ					
K								OBJECT-ORIENTED PROGRAMMING		
KËNGË E KËNGËTARES NË FOTO, "... NË ÇUDIRË"								ORGANIZIMI USHTARAK		
KOHA	NDARËS DHOMASH				BANOR I KUBES					OKSIGJENI
	ILAÇ				PËRFUNDIM NË SHAH					VEGËL (BISED.)
BIZMUTI			STRUC AUSTRALIAN					POLITIKANI FINLANDEZ, REN		
			INDIUMI					UNITED STATES		
KËNGËTARJA SHQIPTARE, BITRI						DRITHI QË I JEPET MULLISIT SI PAGESË				
						IMPULSI				
NDEZJA E HUNDËS								PËREMËR VETOR		

ZGJIDHJET: SISOR, IDARE, NAMAZ, INA, E, TOÇIT, ADON, MA, TT, EKLER, L, ARO, OAN, MBETJE, KULOMB, OOP, NUK BESOJ, O, MUR, KUBAN, BI, EMU, OLI, ANITA, UJEM, RINITIS, TI.

Shumë i lehtë **Sudoku** mesatar

1	8							7	6	7				4			5
	6		7					5	2		5						
				6	1							9		7	2	8	
			9	3		7		8				1	4				7
			1				2								9		
	7		8		4	6				4				6	7		
			4	3								6					3
7	9				2		1			3	1		8			7	
4							2	6				8			1		4

Shumë i lehtë: 185243967, 364798152, 927561843, 649327581, 831956274, 572814639, 216435798, 793682415, 458179326. Mesatar: 672984315, 854613297, 139572864, 591438672, 267159438, 483267951, 946725183, 315846729, 728391546.

BABAI SUPER HERO, ADOPTON 5 FËMIJË ME AFTËSI TË KUFIZUARA



Me beben në krah duke e qetësuar, Ben Carpenter duket si çdo baba tjetër në botë. Por Ben është ndryshe, sepse Noah është fëmija i pestë me aftësi të kufizuara që ai ka adoptuar. Dhe ai thotë se duke parë arritjet e tij, ditët i ka të mbushura me lumturi. "Unë i dua ata. Njerëzit më thonë

se është një punë e vështirë por unë dua çdo gjë që bëj. Ata janë fëmijë të mrekulueshëm. Ata nuk e lënë paftësinë e tyre që t'i kthejë mbrapsht në përparim, ata thjeshtë janë një burim jete", shprehet babai super hero. Beqari Ben 34 vjeç, ishte vetëm 21 vjeç kur aplikoi për të adoptuar

fëmijën e parë, Jack dhe ai beson se është djali më i ri në botë që ka adoptuar fëmijë. Jack, tani 11 vjeç vuan nga autizmi dhe falë përkujdesjes së Ben, ai ka lulëzuar. Super babai më pas adoptoi 7-vjeçarën Ruby, i cili vuan nga sindroma Pierre Robin, skolioza, përdorimi i kufizuar i krahëve si shkak i mungesës së kockave dhe është i verbër. Ai është gjithashtu baba i gjysmës së motrës së Ruby, Lily, gjashtë vjeçe, që është e shurdhër, si dhe Jozefi tre vjeç, i cili ka sindromën Down.



Arrestohet hajduti serial i topave të golfit!

Një ngjarje e pazakontë ka ndodhur në Connecticut të SHBA-së. Një hajdut serial i topave të golfit është arrestuar nga policia. Burri i vodhi topat (me një logo të printuar) nga një klub ekskluziv dhe më pas i shiste në një klub aty pranë. Seriali i vjedhjes së topave të golfit quhet Jozef Kolenda dhe është 58 vjeç. Agjentët e policisë gjetën në shtëpinë e tij rreth 2,500 topa të përdorura dhe me logon Patterson. Menjëherë policët i vunë prangat. Gjykatësi kërkoi dhjetë mijë dollarë për ta liruar Kolendan në shtëpi dhe ai, në heshtje, pagoi shumën e plotë. Ironikisht: ato 10 mijë dollarë janë të barabarta me vlerën e topit që 58-vjeçari ka zhdukur brenda një viti. Flasin për rreth 21 mijë topa vjedhur nga Klubi Patterson.

Djathi i "dehur", që kushton 200 euro

Fabrika "La Caseria Carpenedo" në veri të Trevisos në Itali i zhyt rrotat e djathit në verë. E për këtë arsye djathi i tyre quhet i dehur. Ata bëjnë 15 lloje të ndryshme të djathit të dehur, që mbahet deri në 150 ditë në verë të ndryshme. Fabrika e djathit filloi prodhimin e djathit të "dehur" në vitin 1976, por origjina e saj daton para Luftës së Parë Botërore. Një rrotë e tërë e këtij djathi kushton deri në 200 euro.



Duar të rrudhosura nga uji? Ka një shpjegim

Pas një dushi të gjatë apo mbajtjes së duarve në ujë për një kohë të gjatë të gjithë e kemi vënë re se gishtërinjtë rrudhosen dhe duken sikur të njerëzve në moshë. Në lidhje me një fenomen të tillë për dekada të tëra shkencëtarët kanë besuar se ky reaksion është shkaktuar nga epiderma shtresa e jashtme e lëkurës e cila absorbon ujë përreth saj. Sidoqoftë, në vitin 1935 një grup shkencëtarësh të cilët kishin kryer testime të shumta laboratorike kishin zbuluar se ky reaksion nuk ndodhte kur dëmtohej ndonjë nerv në gishtërinj. Ata kishin rënë në për-

fundim se rrudhat ishin vetëm reaksion i sistemit autonomik nervor të trupit. Referuar kësaj, mësojmë se vetë lëkura dhe veprimtaria e sistemit nervor autonom avatizon njeriun për të qenë efikas në veprimtarinë jetësore në kushtet e lagështa dhe reshjeve me kohëzgjatje. Paraardhësve tanë kjo i ka ndihmuar për të mbledhur ushqim nga bimësia lagështa ose përrrenjtë, të vetmet burime jetësore që mund të kenë patur. Pra ky reagim i lëkurës i jep mundësi njeriut të zotërojë një vlerë të shtuar mbi kontrollin e objekteve të lagura.



1512 - Martin Luteri bëhet doktor i teologjisë (Doktor i Biblës).

1812 - Napoleoni fillon tërheqjen nga Moska.

1849 - Elizabeth Blackwell bëhet gruaja e parë në SHBA që merr diplomën për mjekësi.

1874 - Mary Walsh dhe Charles Colson janë çifti i parë që martohen në balon.

1879 - Thomas Edison demonstroi dritën elektrike.

1912 - Tripoli (Libi) kalon prej duarve të turqve në atë të italianëve.

1914 - Posta amerikane për herë të parë përdorë makinë për të mbledhur dhe dorëzuar letra.

1915 - Rusia dhe Italia i shpallin luftë Bullgarisë.

1921 - Kryeministri portugez António Granjo dhe disa politikanë të tjerë vriten në Lisbonë si rezultat i një krimi të organizuar.


1925 - Armata italiane merr Somalinë.

1960 - Martin Luther King Jr arrestohet në Atlanta.

1962 - Mënjanohet monumenti i Stalinit në Pragë.

2003 - Nëna Terezë lumturohet nga Papa Xhon Pali II.

Akti i "dhënies së çelësit të qytetit", është një vazhdim i një praktike mesjetare ku qytetet zakonisht i mbyllnin dyert gjatë natës, për arsye sigurie. Por ai që kishte marrë çelësin mund të hynte dhe dilte në çdo kohë, dhe kjo cilësohej një nder shumë i madh për individin në fjalë.



Shumica e "parashikimeve" të bëra nga Nostradamusi janë të rreme. Ai nuk parashikoi siç duhet as vetë vdekjen e tij, pasi ishte sekretari i vet ai që e redaktoi parashikimin pas vdekjes së "profetit".



ZVARRANIKU

Mësuesja: Beni më thuaj një emër zvarraniku?

Beni: Gjarpri mësuese.

Mësuesja: Bravo. Po një emër tjetër?

Beni: Një gjarpër tjetër!



Para se ta edukosh gjuhën, edukoje zemrën. Sepse fjala buron nga zemra, pastaj del nga gjuha. (Michelle Obama)



KALENDARI HISTORIK 19 TETOR



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS